PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË ORCA-s (2020-2024)

Prishtinë, 2019

Përmbajtja

Hyrje 5

1. Analiza e gjendjes 6

1.1. Analiza PEST (Politika; Ekonomia; Shoqëria, Teknologjia) 6

1.1.1 Politika 6

1.1.2 Ekonomia 8

1.1.3 Shoqëria 9

1.1.4 Teknologjia 11

1.2. Analiza SWOT 12

1.2.1 Faktorët e brendshëm – Sukseset 12

1.2.2 Dobësitë 15

1.2.3 Mundësitë 16

1.2.4 Rreziqet 16

1.3. Analiza e procesit 17

1.3.1 Analizë e procesit të rekrutimit të personelit 18

1.3.2 Organizimi i ngjarjeve 18

1.3.3 Monitorimi 19

1.3.4 Prokurimi 20

2. Vizioni, misioni, vlerat dhe parimet 21

2.1 Vizioni 21

2.2 Misioni 21

2.3 Vlerat 22

2.4 Parimet 22

2.5 Fushat e intervenimit 22

3. Objektivat strategjike 24
3.1 Menaxhimi dhe procedurat 25
3.1.1 Sigurimi i një hapësire për punë dhe aktivitete (studentët, ngjarje) 25
3.1.2 Hartimi i rregulloreve dhe procedurave qe ndihmojnë funksionimin e organizatës 26
3.1.3 Përcaktimi i qartë i roleve dhe përgjegjësive themelore (organogrami) 26
3.1.4 Angazhimi i personelit për aktivitete e programe specifike 27
3.1.5 Konsolidimi i planifikimit – futja në zbatim i Gantt Chart 27
3.1.6 Përkrahja e ndërsjellë dhe rekrutimi i stafit mbështetës dhe i asistencës 28
3.1.7 Presioni publik për zbatimin e dispozitave ligjore (avokim) 28
3.1.8 Forcimi i rolit të Bordit dhe përmirësimi i organizimit të brendshëm në ORCA 29
3.1.9 Qendra e Aktivizmit Studentor 29
3.1.10 Ngritja e kapaciteteve të OJQ-ve aktive në Arsim të Lartë 30
3.1.11 Hartimi dhe zbatimi i standardeve për hulumtim dhe raportim 31
3.1.12 Monitorimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe i parimeve të etikës akademike nëpër institucionet arsimore 31
3.2 Qëndrueshmëria Financiare 32
3.2.1 Aplikimi për grante nga burime vendore dhe ndërkombëtare 32
3.2.2 Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare 32
3.2.3 Rritja e vizibilitetit të organizatës karshi donatorëve 33
3.3 Zhvillimi i Personelit (ZHP) 33
3.3.1 Ngritja e kapaciteteve të personelit për mbledhje të fondeve 33
3.3.2 Formimi ekipor i personelit 34
3.3.3 Sigurimi i numrit të mjaftueshëm të personelit profesional 34
3.3.4 Angazhimi i vazhdueshëm i vullnetarëve dhe bashkëpunimi i ngushtë me palët e interesit 35
3.3.5 Ngritja e kapaciteteve për hulumtim, monitorim dhe avokim 35

3.3.6 Aftësimi i personelit me PRAG – të KE: 35
3.3.7 Ngritja e kapaciteteve për Menaxhimin e Projekteve 36
3.3.8 Avancimi i mëtejmë kapaciteteve për përpunimin dhe analizën e të dhënave 36
3.3.9 Zhvillimi i aftësive për komunikim dhe marrëdhënie me publikun 37
3.4 Bashkëpunimi e Komunikimi 37
3.4.1 Rishikimi dhe miratimi i një strategjie të komunikimit 37
3.4.2 Hulumtimi i vazhdueshëm i temave relevante, interesimeve dhe shkallës së mobilizimit të studentëve të Kosovës 38
3.4.3 Ngritja e vetëdijes së opinionit publik lidhur me cilësinë e shërbimeve të institucioneve të arsimit të lartë (grupet e interesit në kolegjet private). 39
3.4.4 Luftimi i ndërhyrjeve politike dhe i praktikave negative të autoriteteve arsimore 39
3.4.5 Identifikimi i kauzave të përbashkëta 39
3.4.6 Zhvillimi i komponentës së bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar 40
3.4.7 Përkrahja e krijimit dhe funksionimit të organizatave të pavarura studentore 40
3.4.8 Forcimi i partneritetit me mediet. 41
3.4.9 Platforma mediale për arsim 41
4. Plani i zbatimit dhe buxheti 43
4.1 Korniza për vlerësimin e performancës 45
4.2 Korniza për vlerësimin e rrezikut 46
4.3 Strategjia e komunikimit 48
Shtojca 1: Analiza SËOT 49
Shtojca 2: Plani i veprimi 50

Hyrje

ORCA ka gëzuar një ritëm intensiv të zhvillimit në tri vitet prej themelimit të vet. Organizata ka qenë e fokusuar në aktivitete të ndryshme që kanë trajtuar aktivizmin studentor dhe integritetin akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina". Gjatë kësaj kohe ORCA ka funksionuar kryesisht duke zbatuar grante relativisht të vogla të organizatave vendore e ndërkombëtare. Pas tri vitesh funksionimi të këtillë dhe pas disa sukseseve në fushëveprimin e vet, ORCA ka organizuar procesin e planifikimit të zhvillimit strategjik të organizatës për të siguruar një zhvillim dhe financim më të qëndrueshëm të aktiviteteve të veta. Gjatë procesit të planifikimit janë organizuar dy punëtori me personelin e ORCA-s dhe me partnerët kryesorë nga sektori joqeveritarë.

Më punëtorinë e parë është bërë analiza e gjendjes sipas disa metodave (SËOT, PEST, analiza e procesit, instrumenti i Brunerit e të tjera). Pos kësaj, janë caktuar edhe fushat e intervenimit, vizioni, misioni, vlerat dhe parimet udhëheqëse të ORCA-s. Në punëtorinë e dytë janë identifikuar objektivat strategjike, masat dhe aktivitetet kryesore për realizimin e vizionit dhe misionit të organizatës.

ORCA ka angazhuar një ekspert për të moderuar punëtoritë dhe për të hartuar narrativin e planit zhvillimor. Pos kësaj, personeli i organizatës ka hartuar edhe planin zbatues të Planit Strategjik 2020-2024 dhe ka bërë kostimin e aktiviteteve të planifikuara. Kjo strategji përfshinë këto segmente kryesore:

Fushat e interventimit:

1. Menaxhimi dhe procedurat
2. Qëndrueshmëria financiare
3. Zhvillimi i personelit
4. Bashkëpunimi e komunikimi

Vizioni:

> ORCA është organizatë hulumtuese dhe avokuese e njohur globalisht për zhvillimin e metodologjive të përparuara të jetësimit të parimeve të integritetit akademik dhe gjenerator i nismave për demokratizimin e institucioneve arsimore ne vend dhe më gjerë. ORCA njëkohësisht i mbetet besnike frymës aktiviste, trajtimit dhe reagimit kritik ndaj dukurive shoqërore.

Objektivat strategjike:

> OS 1: Hartohen dhe zbatohen procedura të avancuara me qëllim të sigurimit të menaxhimit efikas të proceseve dhe të resurseve të organizatës.
> OS 2: ORCA zhvillon procedura, kapacitete dhe partneritete që sigurojnë financim të qëndrueshëm të organizatës.

OS 3: Të vendosen procedura të zhvillimit permanent të personelit dhe të ndërlidhjes aktive me vlerësimin e performancës.
OS 4: Të zhvillohet bashkëpunim e komunikim aktiv e ndërveprues me partnerët dhe përfituesit institucional e individual të ORCA-s

Pos këtyre, janë identifikuar edhe 32 masa kryesore dhe më se 100 aktivitete konkrete për realizimin e objektivave përkatëse strategjike.

1. Analiza e gjendjes

1.1. Analiza PEST (Politika; Ekonomia; Shoqëria, Teknologjia)

1.1.1 Politika

Konteksti politik është treguar jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe me ndikim për sektorin e arsimit të lartë në Kosovë gjatë tri viteve të fundit (2016-2019). Zgjedhjet e shpeshta dhe përbërja e koalicioneve qeverisëse kanë ndikuar në mënyrë substanciale në funksionimin e institucioneve të arsimit të lartë. Shkarkimi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe i Ushtruesit të Detyrës së drejtorit të Agjencisë së Akreditimit, largimi nga EQAR, ndërrimi i statusit të Agjencisë Kosovare të Akreditimit në ENQA, emërimi i Këshillit të ri e të tjera e kanë shënuar periudhën dyvjeçare të punës së institucioneve të arsimit të lartë por edhe të ORCA-s. ORCA është angazhuar intensivisht, në bashkëpunim me organizatat qeveritare e joqeveritare, për tejkalimin e situatës së nderë që u krijua me shkarkimin e KSHC-së nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Kjo situatë tregoi për shkallën e varësisë së institucioneve dhe të sistemit nga vullneti, arbitrariteti dhe qëndrimet ad-hok të strukturave në pushtet.

Një aspekt i rëndësishëm i dimensionit politik është edhe korniza ligjore. Konsiderohet se Kosova ka një bazë relativisht të konsoliduar ligjore por implementimi i saj varet nga vullneti i faktorëve politikë. Njëkohësisht vërehet një tendencë për reformim të bazës ligjore me arsye dhe pa arsye, ndryshimi dhe plotësimi i shpeshtë i akteve nënligjore, shpesh pa ndonjë arsye të qartë, mungesa e transparencës dhe llogaridhënies, mungesa e ekspertizës e të tjera. Njëkohësisht, në këtë kontekst të mosimplementimit të dispozitave ligjore, ndodhin shumë nisma për plotësim e ndryshim të kornizës ligjore. Në tri mandate qeveritare në dekadën e fundit, MASHT ka punuar për rishkrimin e ligjit për arsimin e lartë - por pa sukses. Kjo ka ndikuar shumë negativisht në implementimin e tij në vazhdimësi. Të gjitha këto veprime ose mosveprime përbëjnë një kontekst shumë të paparashikueshëm për secilin entitet aktiv në fushën e arsimit dhe të shkencës në Kosovë.

Korniza ligjore dhe të drejtat e parapara në këtë kornizë po ashtu kanë ndikim në funksionimin e organizatës dhe, në veçanti, në zbatimin e projekteve afatgjata. Për ilustrim, pushimet shëndetësore, sigurimet eventuale shëndetësore, lehonia; ndryshimet e kornizës ligjore në drejtim të harmonizimit me atë të Bashkimit Evropian, mund të ndikojnë në ndryshimin e kushteve të veprimit ligjor e financiar të organizatës në plan afatmesëm dhe afatgjatë.

Një ndër brengat më të mëdha për funksionimin e cilësdo organizatë në sektorin e arsimit në Kosovë mbetet politizimi i arsimit dhe i institucioneve arsimore. Politizimi ka qenë problemi kryesor i funksionimit të universiteteve publike në 20 vitet e fundit. Si rrjedhojë, gjashtë universitete të reja rajonale janë themeluar në vend të fakulteteve të mëparshme të UP-së kryekëput për arsye politike dhe si mënyrë për rehatimin e militantëve të partive të caktuara. Kjo ka shënuar një goditje të rëndë për sektorin e arsimit të lartë në Kosovë. Po aq i dëmshëm ka qenë edhe shkarkimi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë nga ana e qeverisë në vitin 2017. Rrjedhimisht, politizimi, partizimi, nepotizmi, kronizmi janë përhapur në të gjitha strukturat e sistemit të arsimit të lartë. Të gjitha këto e kanë dëmtuar rëndë autonominë institucionale, lirinë akademike dhe cilësinë e shërbimeve arsimore në IAL në Kosovë.

Gjendja e rënduar në arsimin e lartë është dëmtuar më tej nga kapja e mediave dhe politizimi i institucioneve të pavarura dhe të bordeve. Në një situatë të këtillë, nuk mjafton angazhimi zhvillimor i OJQ-ve për përkrahjen e institucioneve të arsimit të lartë. Këtu kërkohet mobilizimi i komunitetit studentor përmes aktivizmit studentor, stafit akademik dhe administratës. Për një angazhim të tillë kërkohen edhe aktivitete që përfshijnë hisedarët përmes sensibilizimit të opinionit, mobilizimit të publikut, realizimit dhe publikimit të analizave dhe hulumtimeve së bashku me propozimet për ndërhyrjet konkrete pa përjashtuar format e rezistencës qytetare si aksione simbolike, protesta, greva etj.

Faktorët relevant në sektorin e arsimit të lartë e të shkencës

Pjesëmarrësit në punëtorinë planizuese analizuan faktorët kryesor në sektorin e arsimit që janë me ndikim në funksionimin e ORCA-s gjatë periudhës së planifikuar. Faktorët kryesor dhe roli i tyre paraqitet shkurtazi në vijim:

- Komisioni parlamentar për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini e Sporte mbetet adresë e rëndësishme për organizatat joqeveritare, jo vetëm për rolin që ka në procesin e hartimit të ligjeve por edhe në monitorimin dhe mbikëqyrjen e punës së institucioneve e autoriteteve arsimore në Kosovë.
- Qeveria kosovare: më lartë është analizuar roli negativ i qeverisë në dekadën e fundit. Ndërkaq si burim i financave, mjetet qeveritare mund të determinojnë funksionimin e organizatës dhe fushëveprimin duke ndikuar në pavarësinë e veprimit të OJQ-së, siç ka ndodhur në fushën e kulturës dhe punësimit të të rinjve. Në këtë kontekst duhet kuptuar edhe refuzimin e OJQ-ve për përfshirje në politikë dhe për të shmangur ngjyrimin politik.
- Bashkëpunimi i institucioneve me OJQ-të: këtu vërehen rezerva për bashkëpunim për shkak të mungesës së një kornize ligjore dhe sistemi vet-rregullues që nuk ndikohet shumë nga vullneti ose qasja arbitrare e institucioneve. Është me rëndësi që OJQ-të të krijojnë procedura pozitive bashkëpunimi në të mirë të komunitetit akademik ose shkencorë.
- Bashkëpunimi ndërmjet OJQ-ve: Në kuadër të bashkëpunimit institucional, paraqiten të rëndësishme platformat e OJQ-ve në fusha të caktuara (si për shembull koalicioni KITU) dhe organizimet civile në përkrahjen e arsimit të lartë në nivel vendor, rajonal por edhe më gjerë. Këto nisma dhe organizime kanë qenë shumë efektive në disa raste, siç ishte rasti i përkrahjes së Agjencisë së Akreditimit nga ndërhyrja qeveritare, insistimi për cilësi në promovimin e personelit e të tjera.

- Proceset integruese në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë, internacionalizimi i arsimit të lartë, procesi i Bolonjës dhe bashkëpunimi në Hapësirë Evropiane të Kërkimit Shkencor (ERA) janë identifikuar si faktorë të tjerë të fuqishëm që ndikojnë në punën e entiteteve të angazhuara në sektorin e arsimit të lartë e në shkencë.
- Prania ndërkombëtare në Kosovë, e në veçanti ambasadat e vendeve perëndimore, në shumë raste ka pasur ndikim shumë pozitiv për luftimin e politizimit dhe praktikave jo të mira në AL në Kosovë. Pos kësaj, përkrahja financiare e OJQ-ve nga partnerët ndërkombëtarë ka ndihmuar në ruajtjen e pavarësisë së veprimit të OJQ-ve karshi qeverisë. Megjithatë presioni nga entitetet ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë duhet të jetë vetëm komplementar i mjeteve tjera të përdorura për avokim.

1.1.2 Ekonomia

Në dy dekadat e fundit, Kosova ka shënuar ritme paksa më të larta zhvillimore në rajon. Mirëpo, përkundër kësaj, Kosova mbetet vendi më i pazhvilluar në rajon dhe në Evropë, ndërsa distanca e ngecjes së Kosovës vetëm sa shkon e rritet. Kosova ka shkallën më të ulët të punësimit, ndërsa për nga papunësia e të rinjve prej rreth 55% prinë në Evropë e më gjerë. Një shkallë e tillë e ulët e zhvillimit ekonomik doemos është reflektuar edhe në shkallën e investimit në arsimin e lartë. Kjo shkallë e investimit pastaj reflektohet edhe në efektivitetin e masave të ndryshme për përmirësim të arsimit të lartë. Masat në arsimin e lartë kanë shkallë të ulët të efektivitetit edhe për shkak të përdorimit joefikas të mjeteve në dispozicion nga qeveritë kosovare. Mënyra e financimit të institucioneve të arsimit të lartë karakterizohet nga ndarje lineare dhe shpesh arbitrare të fondeve dhe gjithnjë në dëm të cilësisë së veprimtarisë akademike e shkencore. Edhe fondet ndërkombëtare që ndahen për përkrahjen e arsimit të lartë në Kosovë nuk tregojnë shkallë më të lartë të efikasitetit. Këto fonde pastaj ndodh edhe të kthehen te partnerët ndërkombëtar për shkak të politizimit dhe mungesës së kapaciteteve absorbuese (siç ishte rasti me mjetet e Bankës Botërore në vitin 2019).

Donatorët kërkojnë më shumë përgjegjësi për fondet e alokuara; kërkesat shpesh janë joreale ndaj përfituesve të fondeve (si për shembull të sigurosh qëndrueshmëri pas një projekti njëveçar). ORCA është shumë e kujdesshme në bashkëpunime ku fitohet qasje në fonde qeveritare, kjo për të ruajtur paanshmërinë.

Ndërkaq qasja në fondet ndërkombëtare jo çdo herë është krejtësisht e bazuar në meritokraci – por varet nga agjendat shtetërore e ndonjëherë edhe individuale, prandaj për ORCA-n dhe vizionin e saj në arsimin e lartë, kjo situatë ndonjëherë shndërrohet në sfidë.

Rrallëherë ndodh që donatorë të caktuar kanë tendenca për kontrollim të OJQ-ve, më saktësisht orientimeve të tyre nëpërmjet prioritizimit të qëllimeve të tyre strategjike.

Qëndrueshmëria financiare e ORCA-S lidhet me impaktin e aktiviteteve të OJQ-së. Shumë shërbime të personelit të ORCA-s realizohen pa pagesë - si shërbim komunitar – që nuk i shërben efikasitetit të organizatës por në mënyrë diskrete e shton impaktin e organizatës në komunitetin akademik.

1.1.3 Shoqëria

Ekziston një përshtypje në opinionin publik në Kosovë organizatat e sektorit joqeveritar kanë shumë para dhe abuzojnë me to. Publiku ka mosbesim lidhur me përdorimin e fondeve nga OJQ-të duke dyshuar në pabarësinë e tyre duke i parë aktivitetet e tyre si të nxitura nga jashtë e jo nga baza.

Mosha e re e popullatës në Kosovë bën që arsimi i lartë të jetë nën presion. Sektori i arsimit të lartë karakterizohet nga prania e klisheve në kundrimin e aspekteve të ndryshme të arsimit të lartë, si për shembull orientimi kah diploma ose qëndrimi ndaj praktikave korruptive në universitet.

Sektori civil gjatë pesë viteve të fundit është veçuar edhe për nga kultura e rezistencës, siç është demonstruar në rastin e rektorit Gashi por edhe nga masat përcjellëse (si publikimi i rezultateve, referimi i rasteve në prokurori, protestat, e të tjera) të rasteve të shkeljes së etikës akademike.

Në Kosovë arsimi i lartë shihet si vazhdim i arsimit të mesëm dhe adresë për marrjen e një diplome – jo gjithnjë në profile që garantojnë punësim dhe jo gjithnjë të shoqëruar edhe me kualifikimet dhe kompetencat përkatëse. Kjo ka bërë që të shtohen kërkesat për rritjen e mundësive për studime dhe, njëkohësisht, ka ndikuar negativisht në cilësinë e shërbimeve të arsimit të lartë. Një qasje e këtillë populiste dhe jo shumë produktive është përdorur nga disa grupacione politike për përfitime politike. Po kjo qasje ndikon substancialisht në qëndrimin shpesh herë negativ ndaj OJQ-ve që insistojnë në cilësi në arsimin e lartë në Kosovë.

Mungesa e ndërlidhjes së universiteteve me industrinë dhe nevoja për të bërë një ndërlidhje të tillë

Rënia e ofertës për kualifikim në fushën e shkencave të aplikuara ka bërë që të humbet relevanca e shkollimit të lartë. Studimet universitare shihen si status social ose si shtyrje e problemeve sociale para se të shihen si burim i kualifikimit për nevoja të tregut dhe i punësimit. Ngjashëm me arsimin e lartë, edhe shkenca shihet si një veprimtari e zbrazët që përdoret vetëm në funksion të avancimit akademik, në vend se të prodhojë dije dhe të jetë në funksion të zgjidhjes së problemeve konkrete të shoqërisë e të ekonomisë. Rrjeshimisht, shkollimi në Kosovë nuk ofron doemos punësim e mirëqenie. Si rezultat i kësaj ndodh ikja e trurit nëpërmjet të emigrimit të rinisë në vendet evropiane.

Raporte të ndryshme ndërkombëtare dhe lokale tregojnë se si aftësitë e fituara nga studentët (18 deri 23 vjeç) në Kosovë, nuk përputhen me nevojat e tregut të punës. Sipas një raporti të Bankës Botërore të vitit 2017, "Në Kosovë, forca punëtore e arsimuar dhe e trajnuar në mënyrë jo adekuate mbetet një shtrëngesë kufizuese për kompanitë e mëdha dhe në rritje – duke frenuar kështu zhvillimin dhe duke shkaktuar kosto të mëdha shoqërore sa i përket punësimit". Për më tepër, i njëjti raport thotë se "37.6 përqind e shkallës së fuqisë punëtore në vitin 2015, është thelbësisht

poshtë mesatares rajonale për 70 përqind. Ngjashëm, shkalla e punësimit qëndroi për 25.2 përqind dhe shkalla e papunësisë për 32.19 përqind (dhe dukshëm më keq për gratë dhe veçanërisht për të rinjtë)."

Gjetje të ngjajshme janë publikuar nga entitete të ndryshme, sidoqoftë një hulumtim më i thellë ende nuk është bërë, për të identifikuar shkaqet e këtij fenomeni.

Është një nevojë e theksuar për diskutimin i cili veç ka filluar në shoqërinë kosovare, sa i përket aftësive të fituara nga arsimi i lartë dhe përshtatjes së tyre me nevojat e tregut të punës.

Është i nevojshëm edhe përditësimi i të dhënave ekzistuese rreth mospërputhshmërisë së aftësive të fituara në universitete me nevojat e tregut të punës, meqenëse do të prodhojë të dhëna specifike dhe do të identifikojë zbraztësirat në të gjithë mekanizmat dhe grupet e përfshira (studentët, universitetet, kompanitë, AKA, MAShT).

Studentët

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, numri i përgjithshëm i studentëve në nivelin Bachelor dhe Master në të gjitha universitetet publike në vitin akademik 2018/2019, është 68,533. Numri i studentëve të kolegjeve private për vitin akademik 2018/2019 është 35,987. Numri i studentëve në Kosovë në vitin akademik 2018/2019 i bie të jetë 5,824 për 100,000 banorë. Për krahasim, sipas të dhënave në Eurostat, numri i studentëve për 100,000 banorë në BE në vitin 2017 ishte 3,833.

Numri i profesorëve për kokë studenti në universitetet publike në Kosovë i bie të jetë 52 studentë për 1 profesor. Për krahasim, mesatarja në BE është 15 studentë për 1 profesor, në Serbi 23.9 studentë për profesor dhe në Maqedoni të Veriut është 17 për 1.

ORCA ka vendosur të hulumtojë sa shpenzon një student në Universitetin e Prishtinës, në mënyrë që të kuptojmë natyrën e shpenzimeve, dhe çka mund t'i ofrojnë institucionet këtyre studentëve. Studentët shpenzojnë mesatarisht 37.7 euro për semestër në literaturë të nevojshme për studime. Maksimumi i raportuar arrin 150 euro, ndërsa minimumi 5 euro. Përveç kësaj, studentët gjithashtu shpenzojnë mesatarisht 52.8 euro për semestër në materiale të tjera të nevojshme për studime. Maksimumi arrin 133.21 euro, ndërsa minimumi 10.68 euro.

Raporti i tanishëm hierarkik profesor – student është ndër dimensionet kryesore të kontekstit në arsimin e lartë. Në këtë relacion brengos statusi i studentëve si viktima të keqtrajtuara, në njërën anë, por edhe mungesa e përgjithshme e vetëdijes së studentëve përkitazi me të drejtat por edhe obligimet e tyre, në anën tjetër. Këtë terren më së miri e shfrytëzojnë organizatat studentore të cilat shtyjnë interesa të ngushta grupore apo partiake, duke tentuar t'i joshin studentët përmes disa çështjeve jo shumë relevante në Universitet siç është kërkesa për afate shtesë të provimeve, kërkesë kjo që nuk ndikon domosdo në studime kualitative, në ndërkohë duke injoruar çështje thelbësore si adresimi i duhur dhe rigoroz i ngacmimeve dhe keqtrajtimeve seksuale në Universitet, çështjet e avancimeve akademike jo meritore etj. Një situatë e këtillë ka rezultuar me riciklimin e pushtetit të profesorit nëpër gjenerata dhe me një ndjenjë të pafuqisë ndër studentët. ORCA duhet të angazhohet në fushën e të drejtave

studentore që të rimendohen mekanizmat kryesor siç janë protesta dhe kundërshtimi studentor, të rimendohet kalimi prej qëllimit për një diplomë në një vetëdije kritike që synon dhe kërkon cilësi tjetër të shkollimit, si dhe në fund, kalimi nga vetëdija kritike në vetëdije vepruese jo vetëm të organizatave të shoqërisë civile por edhe i organizatave studentore në mbrojtje të studentëve dhe të cilësisë në arsim.

1.1.4 Teknologjia

Aplikimi i teknologjive të reja dhe sidomos digjitalizimi i proceseve arsimore në arsimin e lartë e në shkencë janë shndërruar në trendë të pandalshme që ndikojnë substancialisht çdo segment të jetës akademike e shkencore. Në UP dhe gjetkë ka filluar digjitalizimi i proceseve arsimore e administrative, përfshirë digjitalizimin e dokumentacionit, prokurimit, pranimit të studentëve të rinj, financave, vlerësimit të studentëve, sigurimit të cilësisë, e ku jo. Kjo siguron qasje më të mirë në informacione relevante por edhe afron shërbimet arsimore me studentin e klientët e tjerë. Njëkohësisht, këto trende mundësojnë qasje më të lehtë në informata, siç është për shembull monitorimi i proceseve arsimore në IAL pa pasur nevojë për vizitë fizike në institucione. Kohëve të fundit teknologjia *cloud* dhe *rrjetëzimi* po ndihmojnë shumë për ndërkombëtarizimin e studimeve. Virtualizimi i studimeve: në kohë reale ose on-demand. Shumica e universiteteve botërore e bëjnë këtë dhe ky trend do të vijë te ne.

Në anën tjetër në fushën e përdorimit të mediave sociale ka trende të ndryshme për nga lloji i mediave sociale dhe i klienteles së përfshirë në to. Në përgjithësi, databazat dhe digjitalizimi i informatave po krijon lehtësi të mëdha edhe për luftimin e praktikave jo të mira, siç është plagjiarizmi, ku përdorimi i ndonjë aplikacioni si Turnitin do të ndikojë në ngritjen e cilësisë së studimeve.

Mirëpo, përparimet teknologjike dhe përdorimi gjithnjë e më i madh i mediave sociale janë të përcjellura edhe me anën e vet negative si krimi kibernetik, ndërhyrjet në privatësi, vjedhja e keqpërdorimi i të dhënave, mashtrimet në teste e punime akademike e të tjera të cilat ndikojnë negativisht në punën arsimore dhe në lirinë akademike. Një pjesë e këtyre praktikave jo të mira, si për shembull krimi kibernetik, mund të ushtrohen në të ardhmen edhe kundër ORCA-s, sidomos kur dihet se aktivitetet e organizatës janë shpesh shumë sensitive.

1.2. Analiza SWOT

Konteksti i organizatës

Gjatë punëtorisë planizuese u krye edhe analiza e kontekstit të brendshëm të organizatës dhe elementet e kontekstit të jashtëm që duhen marrë parasysh për zhvillimet e ardhshme të organizatës. Në këtë fazë të planifikimit pjesëmarrësit u përqendruan në veçanti në faktorët e brendshëm pasi që ishte bërë një analizë PEST e kontekstit më të gjerë më parë. Faktorët e jashtëm janë analizuar kryesisht për të vlerësuar rreziqet e ndryshme që janë jashtë kontrollit të organizatës me qëllim që të mendohen paraprakisht mekanizmat dhe strategjitë që do të bllokonin ndikimet negative në zhvillimin e organizatës.

1.2.1 Faktorët e brendshëm – Sukseset

Përparësitë e identifikuara gjatë analizës SËOT shërbejnë për të ndërtuar mbi to gjatë fazës së planifikimit. Pas shqyrtimit të përparësive të krijuara të organizatës gjatë disa viteve të para të ekzistimit, u vërejt se (i) organizata kishte ndërtuar tashmë një imazh pozitiv dhe (ii) ishte profilizuar me sukses në skenën e organizatave aktive në sektorin e arsimit të lartë e të shkencës në Kosovë. Përparësitë e organizatës mund të ndaheshin në dy grupe të mëdha:

1. Ruajtja dhe kultivimi i karakterit të aktivizmit
2. Profesionalizimi dhe qasja konstruktive së brendi dhe në raport me partnerët e palët e interesuara.

Në grupin e parë të aktivizmit mund të përfshiheshin arritjet në vijim:

- Metodat e reagimit e të presionit dhe fryma aktiviste: Që nga themelimi e tutje ORCA ka qenë organizatore ose pjesëmarrëse aktive në mëse 110 aktivitete me karakter avokues dhe reagues. Përgjatë këtyre aktiviteteve, studentët kanë qenë gjithnjë target, me qëllim që përmes dhe në shërbim të tyre të adresohen çështjet me preokupim për ta, e gjitha kjo si një përpjekje e përbashkët në kontribuimin e përmirësimit të arsimit të lartë në vend. Mbi 700 studentë të ndryshëm kanë marrë pjesë në aktivitetet e ORCA-s gjatë viteve 2018/2019, që në mënyrë të përsëritur shënjojnë 2000 pjesëmarrje në aktivitete. Aktivitetet e ORCA-s me përfshirje studentore me qëllim të inicimit të frymës së aktivizmit studentorë kanë qenë shumëdimensionale si: Aksione Simbolike, Protesta, Marshe, Shkolla Verore për Aktivizmin

Studentor, Kongres i Aktivizmit Studentor, Tubime me Studentë, Vizita Studimore, Trajnime për Studentë etj. Disa nga këto organizime kanë ndikuar në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes më të mirë arsimin e lartë në Kosovë, vlen të përmenden: shkarkimi i prorektores Teuta Pustina përmes presionit publik, për shkak të deklarimeve të saja në fajësim të viktimave të ngacmimeve seksuale, protestë kundër avancimit të Milaim Sejdinit - profesor nën akuzë për ngacmime seksuale, marshe manifestimi për nder të datave historike që i shënjojnë fillesat e aktivizmit studentor në Kosovë etj.

- Në tri vitet e fundit, si rezultat i punës së ORCA-s, kemi një rritje prej 17% të justifikueshmërisë së titullit akademik tek profesorët në UP, dhe kemi shtim prej mbi 500 punime të botuara në revista shkencore, që përbën 25%-shin e të gjitha punimeve të tilla të botuara nga profesorët aktualë që nga vitit 1988. Për më tepër, që nga viti 2017 në UP nuk ka pasur zgjedhje apo avancime profesoriale, në të cilat nuk është plotësuar kriteri formal i punimeve shkencore.
- Krijimi i perceptimit pozitiv në publik: si rezultat i qëndrimit konsistent, në opinionin publik dhe në komunitetin akademik është krijuar një shkallë e lartë besueshmërisë ndaj organizatës;
- Vitaliteti i organizatës dhe guximi në adresimin e çështjeve: ORCA në vazhdimësi ka ruajtur shkallë të lartë të reagimit ndaj dukurive e praktikave jo të mira në komunitetin akademik, duke mos e lënë anash as promovimin e arritjeve dhe praktikave të mira. ORCA në punën e saj vazhdimisht është udhëhequr nga guximi qytetar dhe interesi i përbashkët. Kjo ka siguruar simpati dhe qëndrim afirmativ të opinionit ndaj organizatës dhe aktiviteteve të saj.
- Staf i ri dhe energjik: mosha e re e personelit ka ndihmuar në ruajtjen e frymës aktiviste dhe në angazhimin më intensiv për promovimin e vlerave të organizatës.

Në grupin e profesionalizimit, mund të theksohen elementet në vijim:

- Qasja e mirë në komunikim me publikun dhe partnerët: ORCA ka investuar kohë dhe energji për të ndërtuar partneritete me entitetet relevante, posaçërisht me organizatat studentore si levë e rëndësishme e ndryshimit në arsimin e lartë. ORCA ka ndarë 11 grante të vogla për organizata studentore dhe grupe joformale studentore përmes projektit 3 vjeçar QAINT me ç'rast ka përafruar marrëdhëniet e saj me studentët dhe organizatat e tyre. Në vazhdën e këtij bashkëpunimi, ORCA ka marrë pjesë në komunikata të përbashkëta të reagimit si dhe aksione protestuese të organizatave studentore lidhur me çështje të arsimit të lartë.
- Përkushtimi ndaj çështjeve: ORCA ka krijuar një profil të qartë duke fokusuar përpjekjet e veta në fushën e etikës dhe integritetit akademik, zhvillimit të organizatave studentore, promovimit të aktivizimit, angazhimit konsekuent në promovimin e drejtësisë shoqëore dhe barazisë e të tjera;
- Qasja jokonvencionale dhe radikale në adresimin e çështjeve: ORCA ka shënuar shmangie nga veprimi konvencional i organizatave civile duke kombinuar aktivizmin, profesionalizmin dhe hulumtimin në funksionimin e vet. Po ashtu, ORCA është dalluar për nga vlerësimi real i gjërave e dukurive duke mos u bërë pjesë e percepcioneve të krijuara si rezultat i keqmenaxhimit të arsimit të lartë gjatë dy dekadave të

fundit. Përmes aksioneve simbolike të përgëzimit publik në disa raste të caktuara ORCA ka ndërtuar një imazh të një organizate që nuk fokusohet vetëm në dukuritë negative të arsimit të lartë.

- Kombinimi pragmatik i qasjes kritike dhe bashkëpunuese: gjatë tri viteve të ekzistencës së vet ORCA me insistim ka ndërtuar një profil të organizatës së gatshme për bashkëpunim për promovimin e vlerave pozitive, por edhe të kundërshtimit pa ekuivoke të praktikave jo të mira. Në raste të caktuara ORCA e ka shërbyer Komisionin Parlamentar për Arsim dhe institucionet tjera relevante me raporte monitorimi ex-officio në raste emergjente siç ishte rasti me Agjencinë e Akreditimit (2019) me ç'rast ka parandaluar përplasje institucionale si pasojë e keq-komunikimit dhe keq-informimit. Kjo ka krijuar profil të qartë dhe parashikueshmëri ndër partnerët institucional dhe në opinionin publik në Kosovë.
- ORCA ka marrë pjesë në hartimin e udhëzimeve administrative të MAShT (UA 1/18 dhe UA 7/18), të cilat kanë përcaktuar platformat indeksuses të revistat shkencore ku duhet të publikohet për nevoja të zgjedhjes në titull profesorial. Mbi këto udhëzime, Universiteti i Prishtinës ka avancuar rregulloren e saj për zgjedhjen dhe avancimin e stafit akademik, që ndër të tjerash përcakton se nga viti 2021 vetem punimet e botuara në revista shkencore të indeksuara në dy platformat indeksuese kulmore do të numërohen për nevoja të zgjedhjes dhe avancimit të stafit akademik.
- Korrektësia në hulumtime dhe publikime, dhe aftësitë avokuese: të gjitha publikimet dhe aktivitetet e ORCA-s janë bazuar në standardet më të larta të profesionalizmit dhe të hulumtimit. Për secilin aktivitet hulumtues ORCA ka angazhuar ekspertë të fushës përkatëse duke iu përmbajtur standardeve më të avancuara. Aktivitetet e organizuara janë përgatitur dhe planifikuar me kujdes me pjesëmarrje të partnerëve dhe faktorëve përkatës. Rregulloret e brendshme reflektojnë kërkesën për përsosmëri të produkteve intelektuale të mbështetura ose të realizuara nga ORCA. - Që nga themelimi, ORCA ka implementuar suksesshëm 12 projekte (rreth 587.000.00 Euro) dhe është duke implementuar 3 projekte në fushën e arsimit: QAINT - Cilësi, Llogaridhënie, Integritet dhe Transparencë në arsimin e lartë, e mbështetur nga Agjencia Austriake e Zhvillimit (ADA); Revitalizimi i Aktivizmit Studentor -RESACT, e mbështetur nga Fondi Kombëtar për Demokraci (NED); Promovimi i punës themelore në luftimin e korrupsionit, e mbështetur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). Që nga viti 2016, ORCA ka publikuar mbi 30 raporte hulumtimi, publikime dhe numra të gazetave. ORCA është pjesë e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet (KITU), e përbërë nga 8 OJQ të respektueshme kosovare.

  Të gjitha këto, pothuajse pa përjashtim, janë pritur mirë dhe kanë pasur ndikim pozitiv në opinionin publik.
- Qasja profesionale dhe konsistenca kanë rezultuar me një shkallë të lartë të kredibilitetit të ORCA-s ndër partnerët vendorë e ndërkombëtarë (kronika e radios gjermane deutschlandfunk dhe gazetës së dedikuar të Arsimit të Lartë Times Higher Education me bazë në Londër, si dhe shkrimet publike të ekspertit global të integritetit akademik, Jeffrey Beal).
- Gjatë kësaj periudhe, ORCA është veçuar edhe nga qasja innovative dhe qasja bashkëpunuese me institucionet arsimore. Kjo qasje ka ndikuar në afirmimin e organizatës dhe ka krijuar bazë për ndikim më të fuqishëm në fushën e veprimit të saj.

1.2.2 Dobësitë

Gjatë analizës SËOT janë identifikuar dobësitë e brendshme të organizatës me qëllim të të merren masa për tejkalimin e tyre dhe për t'i transformuar prej dobësive në objektiva e masa zhvillimore. Dobësitë kryesore të identifikuara mund të grupohen në dy grupe kryesore:

- Kushtet e punës
- Aspektet menaxheriale dhe personeli

Në kushtet e punës përfshihen infrastruktura e pamjaftueshme, paqëndrueshmëria financiare dhe mungesa e buxhetit të duhur për realizimin e qëllimeve programore. Në segmentin e infrastrukturës ORCA ka mungesë të numrit të mjaftueshëm të zyrave dhe, sidomos, mungesë të një hapësire për aktivitete zhvillimore për organizatën dhe për partnerët (sidomos studentët). Pasja e një hapësirë të mjaftueshme për realizimin e aktiviteteve ku studentët do të kishin mundësi të përfshiheshin duke e shfrytëzuar infrastrukturën për nevoja të organizimit të ngjarjeve me karakter avokues, do i ndihmonte tejë mase ORCA-s që ta intensifikojë bashkëpunimin me studentët, pasi në perspektivën e ORCA-s, studentët janë ndër katalizatorët kyç në përmirësimin e gjendjes në arsimin e lartë në vend dhe jo vetëm. Në segmentin e financave, ORCA ende vazhdon të funksionojë nga përkrahja e partnerëve ndërkombëtarë. Kjo përkrahje është kryesisht për projekte të vogla dhe afatshkurta me shtrirje të kufizuar veprimi. Natyra e tillë e projekteve nuk jep mundësi për planifikim afatmesëm apo afatgjatë. Shumica e këtyre projekteve nuk kanë ndonjë komponentë zhvillimore për personelin e organizatës, gjë që ndikon në pamundësinë e përcjelljes së duhur të zhvillimeve në fushën e veprimit të organizatës. ORCA ka shmangur deri tani mbështetjen në fondet vendore me qëllim të ruajtjes së pavarësisë vepruese dhe të paanshmërisë në trajtimin e dukurive në sektorin e arsimit të lartë. Mirëpo, një qasje e këtillë nuk ka ndihmuar në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të organizatës.

Si organizatë e re që ka kaluar nëpër procese të hovshme zhvillimore, ORCA ka hasur në vështirësi të shumta të menaxhimit të proceseve dhe të personelit. ORCA ka ndjekur një rrugë ndryshe të zhvillimit të organizatës me qëllim të nxitjes së aktivizmit duke minimizuar apo eliminuar fare burokracinë si metodë funksionimi. Kjo është reflektuar pos tjerash në mungesë të rregulloreve dhe procedurave specifike të shkruara, si dhe të programeve për zhvillimin dhe vlerësimin e performancës së personelit. Megjithatë ndiqen praktika të caktuara të funksionimit organik të organizatës çka ka rezultuar e suksesshme në ekzekutimin e projekteve, raportimin e suksesshëm dhe kalimin me sukses nëpër procedurat e auditimit.

Në segmentin e personelit ORCA është përballur me mungesë të personelit mbështetës dhe teknik dhe në mungesë të kapaciteteve për disa qëllime programore. Në anën tjetër, zhvillimi i hovshëm ka rezultuar edhe me mbingarkim të personelit, si rezultat i pamundësisë së rekrutimit të personelit të ri por edhe i mungesës së ekspertizës së duhur në Kosovë. Gjatë analizës u vërejt se, në plan aftagjatë (më shumë se 5 vjet) mund të krijohet një situatë e shpërputhjes në mes të misionit rinor të organizatës dhe moshës së personelit (mission and aging).

1.2.3 Mundësitë

Sikurse në rastin e sukseseve, mundësitë janë analizuar dhe identifikuar për të parë elementet mbi të cilat do të mund të ndërtohej një strategji dhe masa pozitive zhvillimore.

Gjatë një kohe të shkurtë prej themelimit të saj, ORCA është dalluar nga organizatat tjera për shkak të profilit të qartë (kërkimet shkencore, etika akademike, aktivizmi studentor etj), profesionalizmit dhe ekspertizës specifike në sektorin e arsimit të lartë. Pos këtyre veçorive në fushëveprim, vërehet një imazh pozitiv i ORCA-s ndër mediet dhe ndër studentët si organizatë me standarde të larta profesionale dhe integritet në punë. Ndër mundësitë kryesore për veprimin e ORCA-s është hapur edhe për shkak të nevojës së madhe për organizim të mirëfilltë studentor, për forcimin e aktivizmit studentor dhe për ngritjen e kapaciteteve të organizatave studentore.

Aspekti i dytë i rëndësishëm për suksesin e ORCA-s ka të bëjë me dimensionin dhe proceset ndërkombëtare. Në rend të parë bëhet fjalë për proceset integruese evropiane dhe, në veçanti, me procesin e integrimit në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe në Procesin e Bolonjës. Pos kësaj, suksesi i ORCA-s i atribuohet edhe përkrahjes së organizatave ndërkombëtare (përfshirë praninë ndërkombëtare në Kosovë: Zyra e Bashkimit Evropian, ambasadat, OSBE e të tjera) interesimit të donatorëve për bashkëpunim me organizatat e profilizuara qartë, siç është ORCA.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm dhe pjesë e kontekstit më mundësues për veprimin e ORCA-s ka qenë ndryshimi i qëndrimit të autoriteteve, institucioneve të arsimit të lartë dhe komunitetit akademik ndaj ORCA-s. Në të vërtetë, pas disa nismave dhe veprimeve më të vendosura të studentëve e të shoqërisë civile ndaj autoriteteve të arsimit të lartë vërehej një respekt e frikë më e madhe e institucioneve dhe personelit akademik prej turpërimit publik (aktivitet i ushtruar nga ORCA në disa raste), një qasje më konstruktive e politikës ndaj nismave në Arsimin e Lartë dhe një gatishmëri e shtuar e institucioneve publike për bashkëpunim me studentët e sektorin civil në arsimin e lartë. Njëkohësisht, kjo periudhë shënoi edhe një disponim më të theksuar dhe ndjeshmëri të shtuar të publikut kundruall korrupsionit dhe praktikave jo të mira në sektorin e arsimit të lartë. E gjithë kjo ndodhi në një kohë kur Kosova ka pasur një infrastrukturë ligjore që mundëson transparencë dhe monitorim të pjesëshëm të institucioneve e autoriteteve arsimore. Ky mjedis mundësues dhe dispozitat afirmative ligjore u përdoren maksimalisht nga ORCA dhe nga entitete të tjera të sektorit civil, si për shembull koalicioni KITU, për të vepruar në mënyrë më efektive në sektorin e arsimit të lartë në Kosovë.

1.2.4 Rreziqet

Gjatë periudhës së planifikimit, pjesëmarrësit analizuan edhe rreziqet e ndryshme nga konteksti i jashtëm (pjesërisht jashtë kontrollit të ORCA-s) i organizatës me qëllim të identifikimit të masave për bllokimin e efketeve negative të rreziqeve në mirëvajtjen e punës së organizatës. Rreziqet u organizuan në katër grupe: donatorët, konteksti politik, sektori civil, dhe studimet sektoriale.

Gjatë diskutimit, pjesëmarrësit vërejtën një administrim dhe mbikëqyrje më të kujdesshme të donatorëve ndaj projekteve të tyre dhe një rënie të interesimit dhe të financimit të donatorëve në sektorin e arsimit të lartë. Të dyja këto momente mund të kenë ndikim të rëndësishëm në funksionimin e ORCA-s, sidomos kur dihet orientimi i ORCA-s për të mbajtur një distancë dhe pavarësi karshi autoriteteve vendore (duke mos preferuar konkurimin për fonde vendore qeveritare).

Në anën tjetër u diskutua jostabiliteti dhe paparashikueshmëria e veprimit të autoriteteve dhe institucioneve vendore në arsimin e lartë dhe, rrjedhimisht, ndërhyrjet politike. Për ilustrim u përmend rasti i shkarkimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë nga ana e qeverisë në vitin 2017 pa ndonjë arsye të qëndrueshme ligjore. Jostabiliteti politik, ndryshimet e shpeshta qeveritare dhe mos-zbatimi i dispozitave ligjore nga autoritetet dhe institucionet po ashtu krijonin një kontekst të paparashikueshem dhe të vështirë për organizatat joqeveritare.

Në po këtë kontekst të faktorëve vendorë, u vërejt rezistenca ndaj ndryshimeve në institucionet arsimore, ekzistimi i grupeve të interesit të kolegjeve private dhe apatia e pasiviteti i studentëve dhe mësimdhënësve për ndryshime në sektorin e arsimit të lartë. Kjo apati shpesh shoqërohet nga mungesa e profesionalizmit të disa OJQ-ve aktive në fushën e arsimit dhe nga mungesa e bashkëpunimit të OJQ-ve aktive në po këtë fushë. Si një element rëndues në kontekstin e jashtëm të veprimit të ORCA-s u përmenden edhe fushatat anti-ORCA të disa instancave, grupeve ose individëve që ndihen të kërcënuar nga aktivitetet e ORCA-s.

Në fund u diskutua edhe mungesa e të dhënave dhe informatave të besueshme për realizimin e analizave të mirëfillta sektoriale. Pos mungesës së informatave të duhura, fusha e veprimit të ORCA-s vuan edhe nga mungesa e ekspertizës në fushën e integritetit akademik në arsimin e lartë dhe nga mungesa e qasjes ndërsektoriale. Mungesat e këtilla ndikojnë negativisht në efikasitetin dhe efektivitetin e funksionimit të ORCA-s në sektorin e arsimit të Kosovë.

1.3. Analiza e procesit

Analiza e procesit është një metodë për vlerësimin e gjendjes në organizatë e cila niset nga analiza e hollësishme e proceseve ekzistuese në organizatë. Qëllimi i analizës së procesit është që të identifikohen problemet operacionale në aspekte të ndryshme kryesore të funksionimit të organizatës. Në

seancën e analizës së procesit, pjesëmarrësit kanë analizuar proceset e 1. rekrutimit të personelit, 2. të organizimit të ngjarjeve të ndryshme, 3. monitorimit të mbledhjeve të autoriteteve, 4. prokurimit,.

Vëzhgime përmbledhëse:

Analiza e procesit të disa veprimeve themelore në ORCA (si për shembull organizimi i ngjarjeve me studentë e me mësimdhënës, ose organizimi i monitorimit, organizimi i hulumtimeve e të tjera) tregon për një organizatë shumë efikase por me mundësi që të përmirësohet tutje. Një situatë e këtillë tregon për personel të zhvilluar e të përkushtuar ndaj organizimit të ngjarjeve, me praninë e frymës ekipore në organizatë dhe nevojën për zbatimin e procedurave të shprehura në dokumentin e planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve.

Në anën tjetër, për procedura si prokurimi dhe rekrutimi vërehet mungesa e procedurave dhe rutinave sistematike. Kjo nuk do të thotë se mungon transparenca, objektiviteti dhe llogaridhënia në këto procedura por kërkohet sigurimi i një qasjeje sistematike dhe më koherente përmes hartimit të procedurave dhe rregulloreve përkatëse.

1.3.1 Analizë e procesit të rekrutimit të personelit

Organizata aplikon procedura transparente dhe me pjesëmarrje, mirëpo ato zhvillohen nga përvojat individuale dhe nga vullneti i mirë se sa duke u bazuar në procedura të standardizuara dhe koherente. Procedura e përshkruar e rekrutimit përfshin personelin në të gjitha fazat e domosdoshme, përfshirë edhe vlerësimin e nevojës për rekrutim, përshkrimin e detyrave, shpalljen / publikimin e thirrjes për konkurrim, hartimin e listës së ngushtë, intervistimin, lajmërimin, kontraktimin, informimin fillestar e të tjera.

Gjatë bisedës me personelin e organizatës, u konstatua se ende nuk ka procedura të standardizuara dhe rregullore për vlerësimin e performancës së personelit.

Sugjerim: Kërkohet zhvillimi i procedurave përkatëse për rekrutim, zhvillim të personelit dhe për vlerësim të performancës në organizatë nëse synohet të ruhet stabiliteti i organizatës përkundër zhvillimit të hovshëm.

1.3.2 Organizimi i ngjarjeve

Analiza e procesit të organizimit të ngjarjeve tregoi për një shkallë të lartë të organizimit dhe për praninë e të gjitha fazave të duhura në procesin e organizimit, përfshirë: mbledhjen fillestare, vendimin formal për organizim, rezervimin e objektit/hapësirës/teknikës/përkthimit, adresimin e duhur

të pjesëmarrësve (ftesat, konfirmimet, kontaktimi, rikujtimi), adresimi i medieve, përkujdesja për prezantuesit/folësit, realizimi i ngjarjes, promovimi pasues, dhe vlerësimi i ngjarjes.

Duke mos harruar vlerën e një organizimi të këtillë, ORCA ka të angazhuar një person që mbikëqyr procesin e realizimit të aktiviteteve, natyra e angazhimit të personit përgjegjës është e tipit koordinues (me sektorët e ndryshëm) që siguron mirëvajtje.

Edhe pse mund të krijohet përshtypja se shumëçka në organizimin e ngjarjeve varet kryekëput nga një person dhe se mund të ketë implikime në raste të mungesës së personit në fjalë, ORCA ka zhvilluar një dokument të zbatimit dhe planifikimit të aktiviteteve "Protokolli i Aktiviteteve", dokument ky që ua lehtëson anëtarëve tjerë të personelit mbarëvajtjen e aktiviteteve.

1.3.3 Monitorimi

Analiza e procesit të monitorimit të mbledhjeve në institucione publike ka dëshmuar një qasje të elaboruar si në përgatitje, në dokumentin, dhe në ruajtje të materialeve. Përshkrimi i procesit përfshinë paraqitje të detajuar të informimit për mbledhjen, përgatitjes së monitorimit, zbatimit të monitorimit, raportimit të parë dhe final dhe arkivimit të rezultateve të monitorimit. Organizata nuk ka një udhëzues apo rregullore të monitorimit por ka të vendosur një procedurë shumë komplete. Kjo procedurë si duket nuk paraqet potencial për fyt të ngushtë në proces të implementimit. Në vijim përshkruhet procedura e monitorimit të ngjarjeve dhe mbledhjeve të institucioneve të monitoruara:

Puna në desk-të kuptuarit e datës së mbledhjes

- Monitoruesi sheh ueb-faqen përkatëse në mëngjes dhe në fund të orarit/Dr.ex informohet poashtu përmes kanaleve të tjera
- Identifikohet data e mbledhjes
- Caktimi i monitoruesit (miratimi i Dr.Ex)

Parapërgatitja

- Rendi i ditës si dhe materialet e tjera sipas mundësive
  Printohet forma e raportimit (opsionale nëse ka mundësi incizimi zanor apo përdorim të laptopit)

Monitorimi në terren

- Monitorimi direkt i mbledhjeve
- Raportimi live (në raste të nevojshme te grupi joformal i zyres)

Brief Reporti (gojor)

Raportimi me shkrim

- Forma e raportit e plotësuar dhe e nënshkruar nga monitoruesi
- Transkripta (vetëm në rast se kërkohet nga Dr.Ex)

Futja në dosje

- Vendoset vula e protokolit
- Kryhet dosjimi

Sugjerim: Mund te thuhet se një udhëzues dhe rregullore mund të ishin të dobishme për të siguruar standardizim të proceseve, qëndrueshmëri dhe kujtesë institucionale, sidomos në rastet kur mungon personeli që është i ngarkuar drejtëpërsëdrejti me monitorimin ose kur angazhohen ekspertë ose vullnetarë të jashtëm për lloje të ndryshme të monitorimit.

1.3.4 Prokurimi

Në fushën e prokurimit, organizata ka ofruar një procedurë që aplikohet në një nga projektet që implementohen bashkërisht me organizata të tjera (QAINT). Megjithëkëtë, organizata duhet të zhvillojë procedurat dhe rutinat e veta për prokurim që përputhen me procedurat e donatorëve kryesorë (Komisioni Evropian dhe USAID) ose edhe të autoriteteve shtetërore nëse vendoset që të konkurrohet për fonde vendore. Mungesa e procedurave efikase të prokurimit mund të shkaktojë fyte të ngushta për programet e ndryshme të organizatës në pamundësi të sigurimit të blerjeve të ndryshme për zbatim të projekteve.

<u>Konkluzion i përgjithshëm</u>

Në përfundim të kësaj analize të shkurtë të rrjedhjes së proceseve, mund të konstatohet se organizata funksionon në mënyrë efikase, transparente e llogaridhënëse, mirëpo duke iu falenderuar koordinimit kolektiv. Megjithatë, paraqitet e nevojshme që procedurat dhe rutinat të standardizohen nëpërmjet të rregulloreve dhe udhëzuesve përkatës për kohën kur mund të mungojë personeli përkatës ose kur të angazhohen ekspertë të jashtëm në procedura të ndryshme.

2. Vizioni, misioni, vlerat dhe parimet

Pas analizës së gjendjes (PEST, SËOT dhe Analiza e Rrjedhjes së Procesit), gjatë punëtorisë së dytë planizuese, personeli i ORCA-s dhe partnerët i përcaktuan dimensionet kryesore të planifikimit strategjik. Fillimisht u përcaktua një profil i qartë i organizatës duke deklaruar vizionin, misionin, vlerat dhe parimet udhëzuese në punën e ORCA-s gjatë periudhës pesëvjeçare. Pas tyre u përcaktuan zotimet strategjike në formë të objektivave dhe masave kryesore strategjike për realizimin dhe ruajtjen e profilit të dakorduar. Në grupin e parë të aspekteve kryesore të dimensionit të profilit të oprganizatës, pjesëmarrësit u pajtuan për përkufizimet në vijim:

2.1 Vizioni

ORCA është organizatë hulumtuese dhe avokuese e njohur edhe ndërkombëtarisht për zhvillimin e metodologjive të përparuara të jetësimit të parimeve të integritetit akademik dhe gjenerator i nismave për demokratizimin e institucioneve arsimore ne vend dhe më gjerë. ORCA për të realizuar vizionin e saj i mbetet besnike frymës aktiviste, trajtimit dhe reagimit kritik ndaj dukurive shoqërore.

2.2 Misioni

ORCA është organizatë joqeveritare me fokus në arsimin e lartë dhe në shkencë që mbështet grupet që synojnë demokratizimin e institucioneve arsimore dhe integritetin akademik dhe që besojnë se arsimi duhet të jetë në shërbim të progresit dhe barazisë mes njerëzve.

ORCA angazhohet për cilësi, transparencë, meritokraci dhe integritet në arsimin e lartë dhe në shkencë nëpërmjet të aktiviteteve në vijim:

1. Hulumton dhe monitoron proceset akademike dhe informon publikun për rezultatet.
2. Përkrah aktivizmin studentor
3. Ngre raste përmes aksioneve protestuese dhe gjyqësisë strategjike për të vënë në pah dhe për të trajtuar çështje të transparencës dhe integritetit akademik në Arsimin e Lartë.
4. Avokon në mekanizma vendimmarrës
5. Ndihmon universitetet publike në përpjekjet për integrim në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë.
6. Kontribuon në hartimin e politikave dhe rregulloreve përmes eksperitizës së brendshme dhe të jashtme

2.3 Vlerat

ORCA në veprimtarinë e saj motivohet nga vlerat në vijim:

- Drejtësi shoqërore
- Aktivizmi dhe përkushtimi ndaj detyrës
- Ndryshimi konstruktiv në shoqëri
- Mbrojtja e publikes
- Barazia dhe e drejta për qasje të barabartë në arsim cilësor
- Integriteti akademik dhe cilësia e Arsimit të Lartë

2.4 Parimet

Gjatë procesit të planifikimit dhe diskutimeve lidhur me parimet orientuese të ORCA-s gjatë periudhës së planifikuar, personeli i ORCA dhe partnerët e ngushtë u dakorduan se parimet kryesore në vijim do të shërbejnë si kornizë e veprimit të organizatës:

- Ruajtja dhe promovimi i nteresit publik
- Fryma e bashkëpunimit
- Kritika konstruktive
- Përdorimi efikas dhe transparent i fondeve.

2.5 Fushat e intervenimit

Qysh në punëtorinë e parë, personeli i ORCA-s dhe partnerët diskutuan dhe u dakorduan për fushat kryesore të intervenimit të cilat do të mund të krijonin një kornizë intervenimi për zhvillimin e organizartës për pesë vitet e ardhshme. Këto fusha njëkohësisht tregojnë edhe përparësitë e organizatës përkitazi me fushat e veprimit dhe përgjigjen ndaj zhvillimeve në kontekstin më të gjerë në të cilin vepron organizata. Në fushat e dakorduara të intervenimit përfshihen:

- Menaxhimi dhe procedurat
- Qëndrueshmëria financiare
- Zhvillimi i personelit
- Bashkëpunimi e komunikimi

3. Objektivat strategjike

Për secilën fushë të intervenimit është përcaktuar nga një objektivë strategjike, e cila më tej është përkthyer në masa konkrete që shërbejnë për trajtimin të aspekteve më specifike të fushëveprimit të organizatës.

Menaxhimi dhe procedurat

OS 1: Hartohen dhe zbatohen procedura të avancuara me qëllim të sigurimit të menaxhimit efikas të proceseve dhe të resurseve të organizatës.

ORCA promovon transparencë, llogaridhënie dhe integritet në nënsektorin e arsimit të lartë. Për këtë arsye është e natyrshme që ORCA duhet të shëmbëllejë imazh pozitiv, sjellje efikase dhe përdorim të kujdesshëm të resurseve në dispozicion. Njëkohësisht ORCA duhet të prijë me përdorim të teknologjive e procedurave më të reja në menaxhimin e organizatës. Për këtë qëllim janë të domosdoshme të vendosen procedura të standardizuara e koherente që e udhëzojnë personelin dhe e rregullojnë komunikimin/ndërveprimin e brendshëm dhe të jashtëm të organizatës.

Qëndrueshmëria financiare

OS 2: ORCA zhvillon procedura, kapacitete dhe partneritete që sigurojnë financim të qëndrueshëm të organizatës.

Si një organizatë joqeveritare, është me rëndësi substanciale që ORCA të ruaj pavarësinë e vet vepruese dhe frymën aktiviste. Në kushtet kosovare nuk është e lehtë të realizohet një gjë e tillë për shkak të mungesës së fondeve si për nga sasia dhe nga diversiteti i burimeve. Me fjalë të tjera, varësia nga fondet qeveritare mund të ndikojë në pavarësinë e veprimit të organizatës, siç është dëshmuar me rastin e OJQ-ve të shumta në fushën e rinisë, kulturës e të tjera. Rrjedhimisht, ORCA ka identifikuar strategji të ndryshme për të siguruar qasje në fonde por pa bërë kompromise me vlerat dhe parimet e veta. Në radhë të parë, kjo do të arrihet nga konkurrimi për fonde ndërkombëtare, krijimit të fondeve për aktivizëm studentor, ofrimin e shërbimeve të ndryshme për mbledhje të fondeve e të tjera.

Zhvillimi i personelit

OS 3: Të vendosen procedura të zhvillimit permanent të personelit dhe të ndërlidhjes aktive me vlerësimin e performancës.

Një ndër vlerat kryesore të ORCA-s është personeli i ri, i kualifikuar dhe i përkushtuar për të realizuar misionin, vlerat dhe parimet e organizatës. ORCA në planin e vet zhvillimor është kujdesur që të realizojë zhvillim të tillë të personelit që promovon më tej përkushtimin, frymën ekipore,

menaxhimin transparent dhe efikas të mjeteve dhe nuk heqë dorë nga fryma e aktivizmit studentor dhe nga vlerat më të larta të etikës e integritetit akademik.

Bashkëpunimi e komunikimi

OS 4: Të zhvillohet bashkëpunim e komunikim aktiv e ndërveprues me partnerët dhe përfituesit institucional e individual të ORCA-s

Gjatë tri viteve të para të veprimtarisë ORCA ka ndërtuar një imazh pozitiv si një partner bashkëpunues dhe agjent i ndryshimeve pozitive në sektorin e arsimit të lartë në Kosovë. ORCA ka dëshmuar se mund të trajtohen me sukses edhe çështjet më të ndjeshme në arsimin e lartë përderisa ruhet paanshmëria, objektiviteti dhe përdorimi i të dhënave të verifikuara. Pos kësaj, ORCA ka zhvilluar aktivitete të llojllojshme për krijimin e partneriteteve dhe koalicioneve të qëndrueshme në vend dhe jashtë. Strategjitë e parapara në planin zhvillimor të ORCA-s sigurojnë forcim të mëtejmë të komunikimit të brendshëm e të jashtëm dhe të partneriteteve në të mirë të arsimit kosovar e më gjerë.

Sa i përket masave strategjike, janë zhvilluar gjithsejt 44 masa konkrete, të cilat trajtojnë aspekte më konkrete të funksionimit dhe fushëveprimit të organizatës. Nisur nga fushat respektive, janë identifikuar këto masa: 13 në fushën e menaxhimit, 4 në fushën e financave, 9 në fushën e zhvillimit të personelit, dhe 8 në fushën e bashkëpunimit dhe partneriteteve. Njëkohësisht, secila masë ndahet më tutje në aktivitete specifike të cilat e lehtësojnë procesin e buxhetimit dhe kostimit të Planit Strategjik të ORCA-s për periudhën 2020-2024.

3.1 Menaxhimi dhe procedurat

3.1.1 Sigurimi i një hapësire për punë dhe aktivitete (studentët, ngjarje)

ORCA do të marrë me qera një hapësirë për zyra, takime si dhe pjesën e dedikuar për aktivitete të Qendrës Studentore. Hapësirat duhet të kenë kushte të mjaftueshme për destinimin (punëtori, seminare, tryeza të rrumbullakëta etj.) dhe të jenë të pajisura me teknologji bashkëkohore, përfshirë video-konferencat, uebinaret, video-projeksionet, e të tjera. Një pjesë e hapësirës do të jetë në dispozicion të organizatave studentore, grupeve dhe klubeve joformale studentore për organizim të aktiviteteve të ndryshme, hulumtimeve, takimeve studentore e të tjera, me qëllim të pavarësimit të tyre dhe adresimit adekuat të interesave studentore.

Aktivitetet:

- Identifikimi i hapësirës
- Kontraktimi

- Përgatitja dhe përshtatja e hapësirës
- Furnizimi me pajisje dhe teknologji.

3.1.2 Hartimi i rregulloreve dhe procedurave qe ndihmojnë funksionimin e organizatës

ORCA do të koordinojë procesin e hartimit të rregulloreve dhe procedurave që ndihmojnë funksionim më më të mirë të organizatës, siç janë: rregullorja për komunikim, kontrolli i cilësisë, procedurat për rekrutim dhe zhvillim të personelit, procedura për vlerësim të performancës, standardet për hulumtime, standardet për publikime, e të tjera. Shumica e rregulloreve dhe procedurave hartohen nga personeli i ORCA-s dhe/ose adaptohen nga rregulloret e organizatave partnere. Varësisht nga ekspertiza e nevojshme, një numër i rregulloreve hartohen nga ekspertë të jashtëm vendorë ose ndërkombëtarë të angazhuar nga organizata. Rregulloret e hartuara miratohen fillimisht nga DE dhe pastaj dorëzohen për miratim nga Bordi i ORCA-s. Rregulloret e ORCA-s rishikohen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt një herë në vit.

Aktivitetet:

- Vlerësimi i nevojave për rregullore – lista e rregulloreve për hartim
- Caktimi i personave përgjegjës (sipas sektorit të punës)
- Identifikimi i rregulloreve që duhen hartuar me ekspertizë të jashtme
- Identifikimi dhe angazhimi i autorëve / moderatorëve të procesit
- Organizimi i punëtorisë për rishikimin / hartimin e rregulloreve.
- Miratimi i rregulloreve dhe procedurave të reja / të rishikuara.

3.1.3 Përcaktimi i qartë i roleve dhe përgjegjësive themelore (organogrami)

Do të përpilohet një organogram i cili përcakton ndarjen e detyrave, përgjegjësive si dhe bashkëveprimin e tyre në varësi të nevojave. Përgjegjësitë do të ndahen në bazë të nevojave specifike mirëpo detyra të caktuara do të shpërndahen te të gjithë anëtarët e stafit. Zyra e Drejtorit do ta propozojë një ndarje të tillë e cila do të diskutohet me anëtarët e personelit dhe do të marrë formën përfundimtare në bashkëpunim gjithpërfshirës në organizatë.

Ndarja aktuale e detyrave është e bazuar në Statutin e ORCA-s:

Drejtori Ekzekutiv

Zv. Drejtori Ekzekutiv

Menaxheri i Hulumtimit

Menaxheri i Aktiviteteve

Menaxheri i Administratës dhe Financave

Menaxheri i Projekteve

Sipas Statutit është paraparë që ndarje të reja detyrash mund të caktohen nga Drejtori Ekzekutiv sipas nevojave që mund të paraqiten.

3.1.4 Angazhimi i personelit për aktivitete e programe specifike

(plagjiatura, mirembajtja e databazave te revistave mashtruese – me konsulencë)

Për të lehtësuar angazhimin e ekspertëve të jashtëm vendorë e ndërkombëtar, ORCA do të hartojë një listë të ekspertëve në dispozicion (ang. *pool of experts*) me të cilët do të arrijë marrëveshje në parim për t'i rekrutuar sipas nevojës dhe detyrave konkrete. Do të angazhohen ekspertë/konsulentë për çështje të caktuara që lidhen me realizimin e detyrave për të cilat kërkohen aftësi dhe njohuri specifike. Për këtë qëllim, do të bëhet një vlerësim i nevojave për ekspertizë/konsulencë, do të hartohet lista e ekspertëve/konsulentëve të mundshëm dhe do të përcaktohen nevojat përkatëse buxhetore.

Aktivitetet:

- Shpallja e thirrjes publike në medie elektronike dhe sociale
- Hartimi i listës së ngushtë
- Intervistimi një numri të caktuar
- Identifikimi i ekspertizës për fushat e specializuara
- Nënshkrimi i marrëveshjes bazë.

3.1.5 Konsolidimi i planifikimit – futja në zbatim i Gantt Chart

ORCA do të fillojë ta përdorë aplikacionin Gantt Chart ose aplikacion tjetër përkatës për çështje të avancuar menaxhimin e projekteve. ORCA do ta blejë programet përkatëse të avancuara për qëllime të tilla. Pastaj do të aftësohet personeli për përdorimin e softverit (punëtori).

Aktivitetet:

- Hulumtimi në internet për aplikacionet më të përshtatshme
- Blerja e licencës për aplikacionin e përzgjedhur
- Aftësimi i personelit
- Pilotimi dhe përdorimi i sistemit të ri të menaxhimit të projekteve.

3.1.6 Përkrahja e ndërsjellë dhe rekrutimi i stafit mbështetës dhe i asistencës

Në parim, ORCA është organizatë që promovon angazhim ekipor në të gjitha aktivitetet e organizatës, përfshirë shërbimet e transportit, mirëmbajtjes, logjistikës, e të tjera. ORCA do ta ruajë dhe do ta kultivojë më tej frymën e angazhimit të përbashkët përmes solidaritetit brenda personelit dhe duke i dhënë hapësirë shprehjes së kreativitetit të gjithsecilit nga personelit. Diskutimet dhe vlerësimet e të arriturave dhe ngecjeve në punën e organizatës do të merren parasysh në planifikimin e aktiviteteve të organizatës.

Mirëpo, me rritjen e organizatës, detyrave dhe hapësirave të punës, ORCA do të ketë nevojë profilizim të mëtejmë të personelit dhe, rrjedhimisht, për personel mbështetës dhe teknik. Një gjë e tillë do të krijojë hapësirë për angazhim të personelit të programit në punët profesionale. Në varësi nga zgjerimi i organizatës dhe punës teknike ORCA do të bëjë shpalljen e vendeve të lira të punës dhe rekrutimin e personelit përkatës. Për këtë qëllim do të bëhet vlerësimi i rregullt vjetor ose ad-hok i nevojave për personel teknik dhe mbështetës dhe do të shpallen konkurse për punësim.

3.1.7 Presioni publik për zbatimin e dispozitave ligjore (avokim)

ORCA do të bëjë monitorimin dhe hulumtimin e rregullt të zbatimit të dispozitave ligjore, politikave, planeve të veprimit dhe përmbushjen e zotimeve nga autoritetet dhe institucionet e arsimit të lartë. Në bazë të gjetjeve përkatëse, ORCA do të reagojë me mjete dhe forma të ndryshme për të siguruar zbatim të plotë të zotimeve, në veçanti të atyre që ndikojnë në cilësinë e shërbimeve arsimore, në barazi dhe në drejtësinë shoqërore. Për këtë qëllim ORCA mund të organizojë takime e fushata informimi, avokim tek organet kompetente, publikimin e gjetjeve, presion ndaj menaxhmentit, forma të ndryshme të protestes e të tjera. Për këtë qëllim, ORCA do të organizojë mekanizmat përkatës si rrjete më të qëndrueshme ose ad-hok dhe mobilizim të studentëve e të personelit akademik për ushtrim të presionit publik për zbatim të politikave e dispozitave pozitive.

Aktivitetet:

- Organizimi i monitorimeve dhe hulumtimeve për mbledhjen e të dhënave

- Organizimi i platformave për raportimin e abuzimeve
- Organizimi i rrjeteve për presion konstruktiv ndaj autoriteteve e institucioneve
- Organizimi i takimeve me autoritetet e menaxhmentin e institucioneve, forumeve, ekspozitave, platformave online e të tjera për presion publik ndaj autoriteteve
- Vlerësimi vjetor i punës dhe identifikimi i formave origjinale për ushtrimin e presionit publik.

3.1.8 Forcimi i rolit të Bordit dhe përmirësimi i organizimit të brendshëm në ORCA

ORCA do të fuqizojë bordin e organizatës dhe kuvendin e anëtarëve duke përfshirë në këtë të fundit aktivistët ashtu që llogaridhënia e menaxhmentit të ketë edhe pritje të brendshme (nga organet e përmendura) e jo vetëm të jashtme (nga donatorët dhe auditorët). Do të bëhen ndryshimet e nevojshme statutare dhe do të zhvillohen rregulloret dhe procedurat për raportim të rregullt të brendshëm, për të arritur një llogaridhënie organike dhe sinergji brenda organizatës. Do të ushqehet mendësia e një vendimmarrje koncensuale horizontale.

3.1.9 Qendra e Aktivizmit Studentor

Qendra e Aktivizmit Studentor do të themelohet në zyrat e ORCA-s, me qëllim që të ndihmojë zhvillimin dhe pavarësimin e mëtutjeshëm të organizatave/organizimeve studentore dhe rinore që veprojnë në hapësirën e arsimit të lartë apo të arsimit parauniversitar. Kjo zyrë do të ndihmojë krijimin e organizatave/organizimeve të reja studentore/rinore të cilat do të adresojnë çështje të llogaridhënies institucionale dhe të transparencës. Kjo zyrë do të organizojë aktivitete të rregullta (javore dhe mujore, si për shembull klubi i leximit, i filmit, i debateve, i sportit etj) që nxisin aktivizmin studentor. Pos kësaj, QAS do të fokusohet në aktivitete që sigurojnë pjesëmarrjen aktive të stduentëve në vendimmarrje në IAL dhe në autoritete. ORCA zhvillon aktivitete konkrete për ruajtjen e karakterit aktivist të organizatës. ORCA për këtë qëllim ruan lidhje të qëndrueshme dhe ndërveprimi me grupet përfituese.

ORCA do të punojë për të themeluar fondin për aktivizmin studentor. Qëllimi kryesor i Fondit do të jetë që të sigurojë përkrahje të duhur për të promovuar dhe avancuar frymën e aktivizmit studentor në Kosovë dhe më gjerë.

Krijimi i fondit për aktivizëm studentor do të bëhet përmes ngritjes së fondeve me anë të projekteve të ndryshme te donatorët e zakonshëm. Po ashtu do të shihet mundësia dhe dispozitat e ligjit për sponzorim, nëse bizneset të mund t'i alokojnë paratë e dedikuara për pagesa tatimore si donacione për aktivitete në të mirë të aktivizmit studentor, cilësisë në arsimin e lartë dhe forcimit të organizatave studentore. ORCA po ashtu do të

shpallë në uebfaqen e saj thirrje për donacione të cilat do të dedikohen për funksionimin e mirë të Qendrës si dhe grantimit të organizimit studentor formal e joformal.

Aktivitetet:

- Themelimi i Qendrës
- Sigurimi i hapësirës, i pajisjeve dhe i orendive.
- Organizimi i takimeve, punëtorive, debateve dhe aktiviteteve studentore që promovojnë aktivizmin studentor.
- Hartimi i projekteve për promovimin dhe përkrahjen e aktivizmit studentor
- Ofrimi i shërbimeve këshilluese dhe përkrahja e individëve e organizatave studentore për promovimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe të barazisçë e të drejtës për arsim cilësor
- Shënimi i datave të rëndësishme të aktivizmit qytetar dhe studentor,
- Solidarizim me nisma dhe grupe aktiviste,
- Organizimi i aktiviteteve e fushata me karakter senzibilizimi e avokimi.
- Themelimi i i Fondit për Aktivizëm Studentor
- Konkurrimi për projekte në skemën e sponsorizimit
- Aktivitete të tjera për sigurim të mjeteve.
-

3.1.10 Ngritja e kapaciteteve të OJQ-ve aktive në Arsim të Lartë

Inicimi i aktiviteteve në koordinim me OJQ-të aktive në AL për ndarjen e përvojave të mira në punën e ORCA-s, sidomos në aktivitetet me karakter avokues, hulumtues, monitorues etj., me qëllim të krijimit të hapësirës për bashkëpunim në të mirë të interesit publik. ORCA do të ofrojë asistencë vullnetare dhe të kontraktuar për ngritjen e kapaciteteve të organizatave tjera (përfshirë organizatat studentore) të cilat synojnë të angazhohen në fusha të përafërta apo të njëjta të hulumtimit dhe avokimit në sektorin e AL. ORCA do të krijojë një pako prezantuese të metodave të saj hulumtuese, avokuese dhe të aktivizmit. Ky aktivitet do të menaxhohet drejtpërdrejt nga Drejtori Ekzekutiv.

- Hartimi i pakos prezantuese me modulet e hulumtimit, avokimit dhe aktivizmit të bazuara në përvojat e ORCA-s dhe në përvojat e literaturën tjetër në vend e në botë.
- Zbatimi i programit të aftësimit për organizatat vullnetare

- Vlerësimi i efektit të programit dhe rishikimi i programit.

3.1.11 Hartimi dhe zbatimi i standardeve për hulumtim dhe raportim

Do të hartohen dhe përditësohen procedurat e hulumtimit dhe raportimit në përputhshmëri me standardet e larta etike dhe profesionale bazuar në përvoja ndërkombëtare në fushën e arsimit të lartë. Konsulenca dhe ekspertiza e jashtme do të angazhohet sipas fushave relevante. Si rrjedhojë do të përcaktohen kriteret për verifikim të rezultateve të hulumtimeve dhe të raporteve para publikimit të tyre.

Aktivitetet:
- Angazhimi i konsulencës për hartimin e standardeve për hulumtim e publikim;
- Hartimi i standardeve
- Pilotimi i standardeve
- Prezantimi i rezultateve të pilotit dhe rishikimi i standardeve
- Miratimi i standardeve

3.1.12 Monitorimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe i parimeve të etikës akademike nëpër institucionet arsimore

ORCA do të angazhojë ekspertizë të jashtme përmes konkurseve publike për krijimin e procedurave të monitorimit që do ta sigurojnë zbatimin e ligjshmërisë dhe të parimeve të etikës akademike në institucione arsimore. Po ashtu ORCA do të bazohet në përvojat paraprake të monitorimit. Procedurat e monitorimit do të jenë në përputhshmëri me parimet e paanshmërisë dhe profesionalizmit. Personeli i ORCA-s do të zbatojë monitorim së paku një herë në vit për një segment të rëndësishëm të secilit institucion publik të arsimit të lartë, me fokus në integritetin akademik, në transparencë dhe në llogaridhënie. Për secilin monitorim do të hartohen dhe publikohen raportet përkatëse.

Aktivitetet:
- Identifikimi i ekspertëve për hartimin e procedurave
- Hartimi dhe miratimi i procedurave
- Zbatimi i monitorimeve – së paku 6 në vit
- Hartimi i raporteve
- Publikimi i raporteve

- Organizimi i tryezave për diskutimin e raporteve.

3.2 Qëndrueshmëria Financiare

3.2.1 Aplikimi për grante nga burime vendore dhe ndërkombëtare

ORCA do të përcjellë me vëmendje thirrjet për projekte në fushën e veprimit të organizatës që shpallen nga partnerët zhvillimorë ndërkombëtarë (ambasadat, agjencitë nacionale për zhvillim, kompanitë e ndryshme e të tjera). Në rast se nuk rrezikohet pavarësia e veprimit të organizatës karshi autoriteteve, ORCA do të konkurrojë edhe për fonde vendore. Para çdo konkurrimi të tillë, ORCA do të bëjë vlerësimin e rrezikut për rënien në ndikim të autoriteteve vendore dhe humbjen e frymës së aktivizmit studentor.

Aktivitetet:
- Përcjellja e medieve për të identifikuar thirrjet relevante për projekt propozime
- Krijimi i ekipit për hartim të projektit
- Krijimi i konzorciumeve
- Hartimi i projekteve
- Konkurrimi me projekte.

3.2.2 Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare

Identifikimi i donatorëve potencial, e veçanërisht donatorëve të cilët trajtojnë arsimin e lartë, duke analizuar dhe vlerësuar planet dhe strategjitë e tyre afatgjata.

Lobimi paraprak i interesave të ORCA-s përmes prezantimeve të rregullta nëpër debate publike. Intensifikimi i takimeve me donatorë të ndryshëm me qëllim të parashtrimit të kërkesave për rritjen e fondeve.

Për këtë qëllim ORCA do të identifikojë temat dhe problemet relevante në arsimin e lartë që do të trajtohen nëpërmjet të projekteve konkrete. Pastaj do të ngriten më tej kapacitetet e personelit për hartim të projekteve, si dhe, në raste të caktuara do të angazhohen konsulentë me

ekspertizë të veçantë për hartimin e projekt propozimeve. Ngritja e kapaciteteve dhe hartimi i projekteve nga personeli do të bëhen njëkohësisht në punëtoritë që do të angazhohen për këtë qëllim.

Aktivitetet:

- Identifikimi i problemeve dhe çështjeve që duhet adresuar në arsimin e lartë
- Komunikimi me donatorë dhe autoritete
- Organizimi i punëtorive përkatëse (për hartim të projekteve dhe ngritje të kapaciteteve)

3.2.3 Rritja e vizibilitetit të organizatës karshi donatorëve

ORCA do të përdorë çdo mundësi gjatë organizimit të ngjarjeve të ndryshme, publikimit të raporteve, dhe gjatë zbatimit të aktiviteteve të ndryshme që të sigurojë dukshmërinë e saj në përputhshmëri me rregullat e dukshmërisë së donatorëve. Qëllimi është i dyfishtë: realizimi i rregullave të dukshmërisë e të komunikimit sipas donatorëve të ndryshëm dhe tërheqja e fondeve.

Aktivitetet:

- Hartimi i udhëzuesit për dukshmëri dhe komunikim me partnerë
- Hartimi i materialeve për realizim të dukshmërisë
- Zbatimi i aktiviteteve për realizimin e udhëzuesit për dukshmëri.

3.3 Zhvillimi i Personelit (ZHP)

3.3.1 Ngritja e kapaciteteve të personelit për mbledhje të fondeve

ORCA do të organizojë një punëtori në vit me ekspertë të mbledhjes së fondeve. Do të përpilohet një udhëzues për mbledhje fondesh i cili parasheh edhe hulumtimin e të gjithë donatorëve potencial. Do të ketë takime të vazhdueshme me hisedarë të cilët do të mund të i ndihmonin ORCA-s për ngritje të fondeve.

Aktivitetet:
- Hartimi i udhëzuesit
- Zbatimi i punëtorisë për ngritjen e kapaciteteve për mbledhjen e fondeve
- Hulumtimi i rregullt i donatorëve potencial.

3.3.2 Formimi ekipor i personelit

Personeli i ri njoftohet me historikun e aktivizmit studentor kosovar dhe storiet e suksesit të ORCA-s. Mbahen takime joformale si pjesë të kulturës organizative të ORCA-s, ku mundësohet dhënia e ideve kreative nga secili anëtar i ORCA-s për çështjet që i trajton organizata. Organizohen aktivitete të përbashkëta brenda orarit të punës, të cilat nuk kanë të bëjne me implementim të projekteve e as të punëve ditore. Realizohen punëtori ("Retreat") për ushtrime të formimit ekipor dhe forcimit të pronësisë tek secili anëtarë i personelit.

Aktivitetet:
- Organizohen diskutime të hapura në organizatë për kahet e zhvillimit të organizatës
- Organizohen punëtori të përbashkëta të personelit për të trajtuar tema të ndryshme të ndërtimit të ekipit.
- Organizimi i aktiviteteve zhvillimore për motivimin e personelit (bursa, udhëtime studimore tematike, shënimi i ditëve relevante në fushën e arsimit të lartë e të tjera).

3.3.3 Sigurimi i numrit të mjaftueshëm të personelit profesional

Do të identifikohen nevojat për personel sipas objektivave të organizatës. Analizohen kapacitetet e personelit aktual për caktimin e roleve dhe përgjegjësive. ORCA do të siguroj një numër të konsoliduar të personelit i cili do të jetë i përshtatshëm sipas objektivave afatgjate, dhe do të punësojë anëtarë të tjerë sipas nevojave të projekteve specifike. Procedurat e rekrutimit do të zbatohen sipas standardeve më të larta të transparencës dhe meritës.

Aktivitetet:
- Vlerësimi i nevojave për personel sipas projeksioneve zhvillimore
- Rekrutimi i personelit për realizimin e projeksioneve zhvillimore
- Rekrutimi i personelit për projekte konkrete

- Zbatimi i programit fillestar të aftësimit (induction training)

3.3.4 Angazhimi i vazhdueshëm i vullnetarëve dhe bashkëpunimi i ngushtë me palët e interesit

Përmes bashkëpunimit me IAL-të do të sigurohet një numër i caktuar i studentëve vullnetarë që do të angazhohen në ORCA për nevoja të studimeve të tyre dhe aftësimit profesional. Këta vullnetarë do të ndërrohen pas një periudhe të cakutar. Kjo do të mundësojë kontakt më të madh të ORCA-s me studentë të cilët më tutje do të mund të angazhoheshin edhe si personel me orar të plotë në ORCA apo si aktivistë në çështjet që i ngritë ajo.

Aktivitetet:
- Shpallja e konkursit për vullnetarë (sipas aktvitieteve dhe temave të caktuara)
- Përpunimi i aplikacioneve dhe angazhimi i vullnetarëve
- Certifikimi i studentëve vullnetarë
- Rekrutimi i studentëve të dalluar në përputhje me nevojat e organizatës.

3.3.5 Ngritja e kapaciteteve për hulumtim, monitorim dhe avokim

ORCA do të ngrisë kapacitetet për (i) për hulumtim të dukurive në arsimin e lartë, (ii) për monitorim dhe avokim, si dhe për (iii) komunikim dhe partneritet. Ngritja e kapaciteteve do të jetë mënyrë e funksionimit të organizatës për ta shndërruar atë në organizatë të të nxënit. Për këtë qëllim ORCA çdo vit do të organizojë së paku një ngjarje për secilin nga temat e mësimpërme për zhvillim të kapaciteteve. Në rast se nuk do të ketë burime financiare të donatorëve për këtë qëllim, ORCA do të organizojë ngritjen e kapaciteteve me bazë në organizatë nëpërmjet të shkëmbimit të përvojave në mes të personelit dhe partnerëve.

Aktivitetet:
- Organizohen së paku një punëtori në vit për secilën nga tri temat e mësipërme.
- Bëhet vlerësimi i punës së përsonelit për arritjen e objektivave për mbledhjen e fondeve.

3.3.6 Aftësimi i personelit me PRAG – të KE:

Me qëllim të ruajtjes së pavarësisë vepruese, ORCA është orientuar kah sigurimi i fondeve për funksionim kryesisht nga burime ndërkombëtare. Kohëve të fundit, donatorët në Kosovë, siç janë Zyra e BE-së, ADA austriake, GIZ-i gjerman e të tjera, janë duke bërë monitorimin dhe mbikëqyrjen më rigoroze të zbatimit të projekteve të veta. Një numër donatorësh, siç është USAID-i amerikan dhe Fondacioni KFOS, janë tërhequr nga arsimi i lartë. Kjo i ka kufizuar mjetet në dispozicion për organizatat joqeveritare aktive në sektorin e arsimit të lartë, si dhe janë rënduar kushtet e raportimit për zbatimin e projekteve. Për këtë qëllim ORCA do të bëjë aftësimin e personelit në fushën e menaxhimit financiar të projekteve evropiane (PRAG). Kjo do të bëhet përmes një punëtorie aftësuese triditore në Kosovë. Personeli përgjegjës për financa dhe prokurim do të vijojnë edhe një kurs plotësues dyditorë për të përvetësuar më hollësisht procedurat e PRAG.

Aktivitetet:
- Identifikimi nevojave për aftësimin e personelit në fushën e financave dhe prokurimit
- Hartimi i programit për aftësim
- Zbatimi i programit (punëtori, vijim i kurseve në vend dhe jashtë, kualifikim, udhëtime studimore).

3.3.7 Ngritja e kapaciteteve për Menaxhimin e Projekteve

ORCA do të organizojë një program aftësimi për personelin në fushën e menaxhimit të ciklit të projektit. Fillimisht do të angazhohet një organizatë implementuese e cila do të bëjë vlerësimin e nevojave në fushën e menaxhimit të projekteve dhe hartimin e planit të aftësimit. Programi do të përbëhet nga punëtori dhe aftësim në vendin e punës. Personeli do të angazhohet në implementimin e aktiviteteve nga programi i aftësimit. Pas zbatimit të programit, menaxhimi i projekteve do të jetë pjesë e vlerësimit të performancës së personelit.

Aktivitetet:
- Identifikimi dhe rekrutimi i kompanisë implementuese
- Hartimi dhe miratimi i planit të aftësimit
- Zbatimi i planit (dy punëtori dhe detyra në mes të punëtorive)
- Vlerësimi i programit

3.3.8 Avancimi i mëtejmë kapaciteteve për përpunimin dhe analizën e të dhënave

Do të ofrohen trajnime profesionale për zhvillimin e kapaciteteve të hulumtimit, ku do të vihet theks në analiza kualitative dhe të interpretimit të të dhënave. Do të ngritën kapacitete për përdorimin e softuerëve të tipit: SPSS, ATLAS etj.

Aktivitetet:

- Organizimi i programit të aftësimit për përpunim e analizë të të dhënave (mund të përfshihen edhe mësimdhënës e studentë të institucioneve të arsimit të lartë)
- Blerja e programeve për përpunimin e të dhënave
- Aftësimi i personelit për përdorimin e programeve (SPSS, ATLAS);

3.3.9 Zhvillimi i aftësive për komunikim dhe marrëdhënie me publikun

ORCA cakton përgjegjësitë e personelit lidhur me aspekte të ndryshme të komunikimit dhe marrëdhënie me publikun. Detyrat ndahen për segmentet në vazhdim: administrimi i mesazheve elektronike, mbikëqyrja dhe ushqimi i uebfaqes dhe profilit ne rrjetet sociale, koordinimi i medieve, bashkëpunimi me autoritetet dhe institucionet e AL, përgjegjësia dhe rregullat e komunikimit të brendshëm, marrëdhëniet me Bordin, etj.

Varësisht nga detyrat e caktuara bëhet edhe ngritja e kapaciteteve. Për këtë qëllim hartohet programi i aftësimit për MP. Në këtë program përfshihen punëtori, udhëtime studimore, aftësim në vendin e punës, e të tjera. Në këto punëtori dhe programe aftësimi mund të përfshihen edhe personeli i organizatave partnere. Do të organizohen vizita ndërkombëtare për të përfituar përvoja të reja në fushën e avokimit. Sipas nevojës do të angazhohet staf me kontratë për punë të caktuar (konsulentë) për hulumtime në fushave të ngushta.

Aktivitetet:

- Hartimi i programit të aftësimit në fushën e komunikimit;
- Zbatimi i programit të komunikimit (tri punëtori, një udhëtim studimor, aftësimi në vendin e punës).
- Organizimi i vizitave studimore (një në vit) në fushën e lobimit;
- Vlerësimi i efektit të programit aftësues – duke vlerësuar performancën e personelit.

3.4 Bashkëpunimi e Komunikimi

3.4.1 Rishikimi dhe miratimi i një strategjie të komunikimit

ORCA në vitin 2017 ka zhvilluar një strategji të komunikimit. Kjo strategji do të rishikohet nga personeli i ORCA-s dhe një eksperti të pavarur vendor për të konstatuar zbatimin ose mos-zbatimin e masave të parapara në strategji. Pastaj do të hartohet strategjia e re, për t'iu përshtatur

kushteve të reja (konteksti i ndryshuar dhe rritja e organizatës). Strategjia do të zhvillohet me një qasje pjesëmarrëse të personelit dhe të partnerëve. Pjesë të strategjisë do të publikohen për partnerët.

Aktivitete:
- Rishikimi i strategjisë ekzistuese
- Krijimi i grupit përgjegjës për hartimin e strategjisë së re të komunikimit
- Hartimi i startegjisë së re (një punëtori)
- Shtypja, publikimi dhe shpërndarja e pjesëve të caktuara.

3.4.2 Hulumtimi i vazhdueshëm i temave relevante, interesimeve dhe shkallës së mobilizimit të studentëve të Kosovës

ORCA do të organizojë hulumtime të rregullta të rrjedhave në jetën studentore, trendeve akademike, dinamikës së organizimeve studentore, çështjeve kryesore në jetën akademike, tendencave në frymën e aktivizmit studentor e të tjera. Në bazë të rezultateve të hulumtimeve ORCA do të hartojë programe përkitazi me aktivizmin studentor. Nga këto programe do të dalin tryeza, projekte, nisma, organizime të ndryshme e të tjera. Mjetet për realizimin e këtyre projekteve do të kërkohen nga donatorët e ndryshëm. Aty ku do të jetë e mundur, ORCA do të zbatojë aktivitete të ndryshme në këtë fushë me punë vullnetare dhe me organizime studentore. Fryma aktiviste do të promovohet edhe përmes rekrutimit të personave të motivuar dhe organizimi i takimeve motivuese. ORCA do të organizojë takime të rregullta tematike (mujore ose dyjavore) ku stafi, aktivistët, vullnetarët, personat e afiliuar në ndonjë mënyrë me ORCA-n, marrin pjesë dhe diskutojnë për nevojën, mënyrat dhe problematikat ku duhet intervenimi përmes aktivizmit studentor. Këto takime duhet të rezultojnë me aktivitete të ngritjes së vetëdijes për çështjen në fjalë të cilat nuk janë të kushtueshme dhe të cilat mund të adaptohen në planet e punës së ORCA-s.

Aktivitet:
- Organizimi i hulumtimeve lidhur me tendencat dhe zhvillimet kryesore në fushën e aktivizmit studentor
- Hartimi i programit për promovimin e aktivizmit studentor
- Organizimi i aktiviteteve vullnetare
- Organizimi i takimeve të rregullta tematike për nevoja të aktivizmit studentor.

3.4.3 Ngritja e vetëdijes së opinionit publik lidhur me cilësinë e shërbimeve të institucioneve të arsimit të lartë (grupet e interesit në kolegjet private).

ORCA do të organizojë aktivitete për informim të plotë për të gjeturat nga projektet hulumtuese dhe analizat sektoriale të ORCA-s. Për këtë qëllim ORCA do të organizojë tryeza të rrumbullakëta, forume, takime informative, promovim të publikimeve, debati në media, platforma online, e të tjera. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është që të ngritet vetëdija e opinionit nga përspektiva e llogaridhënies dhe transparencës në përdorimin e fondeve publike.

Aktivitetet:
- Organizime të ndryshme sipas vlerësimit (pesë ngjarje në vit).
- Vlerësimi i efektit të organizimeve.

3.4.4 Luftimi i ndërhyrjeve politike dhe i praktikave negative të autoriteteve arsimore

ORCA zhvillon dhe zbaton metoda të ndryshme të presionit publik ndaj autoriteteve dhe IAL për promovimin e transparencës dhe ndryshimeve në arsim (open data dhe mbledhja eefikase e të dhënave). Këtu përfshihen edhe reagimi publik dhe përdorimi i metodave aktiviste në adresimin e ndërhyrjeve politike në AL e shkencë; publikimi i storieve të suksesit në luftimin e korrupsionit; ndërtimi dhe forcimi i vazhdueshëm i partneritetit me Komisionin Parlamentar ASHKRS.

Aktivitetet:

- Organizimi i një shërbimi për informimin e hershëm të praktikave të abuzimit përmes ndërhyrjeve politike (ëistlebloëing);
- Organizimi i ngjarjeve si përgjigje ndaj ndërhyrjeve politike (publikimeve dhe storieve në rrjeta sociale, protestat studentore, organizimi i takimeve me udhëheqjen, denoncimi në prokurori, e të tjera).
- Organizimi i takimeve të rregullta vjetore me Komisionin Parlamentar për ASHRKS;
- Publikimi i listave të ndërhyrjeve për turpërim publik; etj.

3.4.5 Identifikimi i kauzave të përbashkëta

të organizatave joqeveritare dhe inicimi i mënyrave të reja të bashkëpunimit për realizim të qëllimeve të përbashkëta.

ORCA do të mbajë sesione të brendshme të rregullta të stuhive të mendimit (brainstorming) për t'i identifikuar kauzat e mundshme të përbashkëta me organizatat nga fusha e arsimit. ORCA do ta bëjë këtë edhe në nivel të Ballkanit Perëndimor. Do të krijohen raporte të brendshme të cilat do të shërbejnë për zhvillimin e takimeve me organizatat e mundshme partnere si dhe ofertimin për përbashkim në kauza të caktuara.

Aktivitetet:

- Identifikimi i kauzave të përbashkëta – punëtori ose tryeza të përbashkëta
- Inicimi i aktiviteteve në mbrojtje / promovim të kauzave të përbashkëta.

3.4.6 Zhvillimi i komponentës së bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar

Në raport me organizimet dhe organizatat studentore rajonale të cilat mëtojnë avancimin e arsimit publik dhe cilësisë në arsimin e lartë, ORCA do të mbajë kontakte të rregullta përmes takimeve dhe organizimeve të ndryshme. Çdo vit do të zhvillohet një raport i brendshëm i gjendjes së organizimit studentor në vendet e rajonit dhe më gjerë. Ky raport do të shërbejë për veprimtarinë rajonale të ORCA-s.

Aktivitetet:

- Komunikimi i strukturuar dhe aktiv me organizatat simotra nga rajoni
- Hartimi i një raporti për gjendjen e organizimit studentor në rajon
- Hartimi i projekteve të përbashkëta për avancimin e organizimit stduentor në rajon.

3.4.7 Përkrahja e krijimit dhe funksionimit të organizatave të pavarura studentore

ORCA do t'i involvojë organizatat studentore në bashkëorganizim të aktiviteteve të ndryshme me qëllim të hapjes së horizonteve të tyre drejtllojeve të reja të aktiviteteve. ORCA do të aplikojë për projekte ku mund të ndajë fonde të vogla me qëllim të rritjes së aftësive të tyre për të menaxhuar projekt. ORCA do t'i ndihmojë organizatat studentore të aplikojnë për projekte me fonde më të mëdha me qëllim të pavarësimit të tyre financiar që mund të sigurojë edhe autonomi të shtuar nga ndikimet politike.

Në kuadër të Qendrës së Aktivizmit Studentor ORCA do të ketë program të rregullt të ndërtimit të aftësive për krijimin e grupeve joformale, klubeve, organizatave, lëvizjeve. Kjo do të mundësojë krijimin e organizatave/organizimeve të reja studentore.

Aktivitetet:

- Hartimi i projektit për grante të vogla për rritjen e aktivizmit dhe pjesëmarrjes studentore
- Shpallja e thirrjes për grante të vogla
- Ndarja e granteve dhe monitorimi i zbatimit të projekteve.
- Shpallja e thirrjes për përkrahjen e funksionimit të organizatave studentore
- Ndarja e granteve dhe monitorimi i zbatimit të tyre.

3.4.8 Forcimi i partneritetit me mediet.

Drejtori Ekzekutiv do të organizojë 4-5 takime me hisedarë ku do të marrin pjesë gazetarët, redaktorët dhe drejtuesit e tjerë të medieve. Këto takime do të jenë joformale dhe do të shërbejnë për informimin më të detajuar të medieve lidhur me problematikat që ato i shpërfaqin në platformat e tyre. Për çdo takim do të hartohet një raport i brendshëm të cilët do të përdoren për të analizuar gjendjen në arsim siç është paraparë në aktivitetet përkatëse më lartë (3.4.3.).

Aktivitetet:

- Aranzhimi i takimeve
- Përgatitja e materialeve tematike
- Zbatimi i takimeve.

3.4.9 Platforma mediale për arsim

Mungesa e një platforme mediale që i dedikohet në tërësi arsimit është teren që ORCA do ta eksplorojë duke zhvilluar tutje gazetën satirike studentore në një platformë dixhitale e cila do të ngërthente në vete disa komponenta duke ruajtur karakterin e saj satirik, por edhe duke ofruar komponenta që mungojnë aktualisht në mediet vendore.

Aktivitetet

- Kontraktimi i ueb dizajnerit dhe programerit
- Lansimi i faqes
- Punësimi i profesionistëve
- Mirëmbajta e faqes
- Prodhimi i materialeve

- Blerja e pajisjeve për video produksion

4. Plani i zbatimit dhe buxheti

Plani i zbatimit dhe buxheti, përfshijnë gjithë periudhën e zbatimit të Planit Zhvillimor të ORCA-s për vitet 2020-2024. Kostoja totale e zbatimit të PZHA për periudhën 2020-2024 është vlerësuar të jetë 689.850€. Si plani i zbatimit, ashtu edhe edhe planifikimi i buxhetit brenda periudhës së planifikuar, janë orientues dhe në parim kërkojnë të rishikohen në baza vjetore. Pjesa më e madhe e shpenzimeve të buxhetit për realizimin e planit janë paraparë të jetë nga mjetet e donatorëve të gjeneruara nëpërmjet të projekteve dhe granteve të ndryshme.

Para fillimit të çdo viti fiskal, ORCA duhet të analizojë me kujdes fondet në dispozicion nga projekte të ndryshme, nga mjetet e gjeneruara nga aktivitetet e ndryshme dhe nga donatorët të tjerë, me qëllim që të sigurohet financim i qëndrueshëm i veprimtarisë së organizatës.

Tabela në vijim, prezanton përmbledhjen e buxhetit të nevojshëm për realizimin e planit, sipas fushave të intervenimit.

Fushat e intervenimit	Buxheti sipas viteve					Gjithsejt për fushë
	2020	2021	2022	2023	2024	
Menaxhimi dhe procedurat	73350	61750	66950	61750	62250	326050
Qëndrueshmëria financiare	22500	15000	15000	20000	17500	90000
Ngritja e kapaciteteve	21500	9500	15500	12500	15500	74500
Komunikimi dhe bashkëpunimi	46600	36300	36300	38800	41300	199300
Gjithsejt për vit	163950	122550	133750	133050	136550	689.850

Masat e parapara në këtë plan janë të gjitha të karakterit zhvillimor dhe nuk përfshijnë shpenzimet operative (pagat, mirëmbajtjen e rregullt të objekteve, shpenzimet komunale, shpenzimet për ngrohje dhe të tjera). Shpenzimet kryesore të planit janë investimet në aktivitete hulumtuese, monitoruese dhe zhvillimore me karakter programor (për avancimin e shërbimeve të arsimit të lartë sipas prioriteteve të vendosura), si dhe në veçanti, masat për përkrahjen e aktiviteteve studentore.

Plani parasheh që gjatë pesë viteve të ardhshme ORCA duhet të sigurojë rreth rreth 140,000 euro në vit nga burime të ndryshme për të mundësuar realizimin e tij. Një shumë e tillë nuk paraqitet e pamundshme nëse merren para sysh imazhi pozitiv dhe projektet e suksesshme në disa vitet e fundit. Investimet në infrastrukturë paraqesin një pjesë të vogël të shpenzimeve vjetore (kryesisht për sigurimin e objektit për Qendrën e Aktivizmit Studentore. Pjesa kryesore e shpenzimeve (rreth 50 % e shumës së përgjithshme, parashihet për aktivitetet hulumtuese, monitoruese dhe raportuese (masa 1.13, rreth 200000 €), si dhe në aktivitete të ndryshme me organizatat studentore (masat 4.2 e 4.7, rreth 130000 €), përfshirë edhe Qendrën e Aktivizmit Studentor. Pjesa e mbetur parashihet për zhvillimin e rregulloreve e procedurave të ndryshme, për zhvillimin e personelit të ORCA-s dhe për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare. Struktura e shpenzimeve të parapara të këtij plani reflekton edhe prioritetet zhvillimore të ORCA-s në periudhën e planifikuar, që janë menaxhimi më i mirë (si organizatë e re), aktivitete me komunitetin akademik, hartimin e projekteve për aplikim për fonde të donatorëve, e të tjera. Këto janë plotësisht në koherencë edhe me misionin e vizionin e organizatës të shprehura në krye të këtij plani.

Në shtojcën e buxhetit të këtij plani (Shtojca X) janë prezantuar detajet e planit të veprimit dhe të buxhetit, përfshirë aktivitetet sipas masave, treguesit për aktivitetet sipas masave, periudha e zbatimit, përgjegjësitë, institucioni/organizata mbështetëse, përshkrimi i buxhetit dhe ndarja e buxhetit në vite.

4.1 Korniza për vlerësimin e performancës

Një zyrtar i ORCA-s do të angazhohet drejtpërsëdrejti për monitorimin e zbatimit dhe informimin e menaxhmentit, respektivisht donatorëve, autoriteteve, partnerëve e të opinionit për procesin e zbatimit të planit. ORCA të organizojë mbledhjen e rregullt të informatave dhe raportimin vjetor lidhur me cilësinë e zbatimit të Planit, si dhe do të informojë palët e interesit lidhur me këtë. Për këtë qëllim janë identifikuar një listë e treguesve që do të shërbejnë si referenca për përcjelljen e zbatimit të Planit. Kjo listë përfshinë aspektet kryesore të strategjisë, si për shembull, rregulloret, raportet nga hulumtimet, publikimet e ndryshme, marrëveshjet e bashkëpunimit, programet e aftësimit të personelit e të tjera. Personeli i ORCA-s me ndihmën e ekspertizës së jashtme do të hartojnë dhe zbatojnë një Kornizë për Monitorimin e zbatimit të Planit për të matur zbatimin e masave strategjike të planit, relevancën, dhe ndikimin e masave të planit.

Indikatori	Baseline	2022	2024
Numri i personelit	7	9+6	15
Numri i organizatave partnere	16	20	25
Numri i projekteve – ongoing	4	5	5
Numri i projekteve – completed	10	13 +	
Numri i partneriteteve	6		
Numri i trajnimeve për përfituesit	17	20	40
Buxheti …	547 000	700 000	900 000
Numri i studentëve të përfshirë në aktivitete	2000	4000	8000
Numri i profesorëve hulumtuar	568	900	N/A
Numri i raporteve të publikuara	21	26	30
Numri i publikimeve	31	45	60
Numri i rregulloreve e procedurave	3	11	
Hapësira m2	65	200	250
Numri i aktivistëve	40	200	400
Numri i trajnimeve për personelin	4	10	15
Numri i udhëtimeve studimore	4	8	12
Nr. i kurseve formale vijuar nga personelit	1	3	6
Nr. I kurseve joformale të personelit	3	6	12

4.2 Korniza për vlerësimin e rrezikut

Gjatë hartimit të Planit Zhvillimor të ORCA-s, grupet punuese janë angazhuar edhe për vlerësimin e rreziqeve të ndryshme, faktorë kryesisht jashtë kontrollit të organizatës – që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e suksesshëm të Planit. Identifikimi i rreziqeve u bë gjatë analizës SËOT, ashtu edhe gjatë hartimit të masave dhe aktiviteteve për realizimin e objektivave të planit. Rreziqet janë analizuar pa një renditje të caktuar, duke analizuar shkallën e probabilitetit dhe shkallën e mundshme të ndikimit në zbatimin e masave të planit. Siç do të shihet në tabelën në vijim, shumica e rreziqeve të zbatimit të këtij Plani lidhen me autoritetet shtetërore, me përfituesit e shërbimeve të ORCA-s, mungesa e ekspertizës (për shkak të profilit relativisht të specializuar të ORCA-s) e të tjera. Në fund, shkurtimisht janë menduar edhe strategjitë e ndryshme për parandalimin, zvogëlimin e efektit negativ ose për tejkalimin e rrezikut. Në vijim janë rreziqet kryesore dhe analiza e tyre.

Rreziqet – cfarë të shmanget!	Prioriteti 1-5	Probabiliteti 1-3	Ndikimi 1-3	Masat / strategjitë parandaluese
Ndryshimet e shpeshta dhe paqëndrueshmëria qeveritare	4	2	2.5	Vendosja e bashkëpunimit të qëndrueshëm me institucionet e arsimit të lartë dhe me organizatat studentore
Arbitrariteti ne zbatimin e dispozitave ligjore	4	2	2	Informimi i opinionit publik për kornizën ligjore dhe reagimi i shpejtë/presioni ndaj praktikave jo të mira
Apatia dhe pasiviteti i studentëve e mësimdhënësve	4	3	2.5	Organizimi i aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes dhe aktivizmin studentor; organizimi i aktiviteteve për motivimin e nxitjen e pjesëmarrjes aktive.
Mungesa e ekspertizës në fushën e integritetit akademik në AL	4	3	1	Angazhimi i ekspertizës vendore e ndërkombëtare. Zhvillimi i kapaciteteve vendore dhe i personelit
Mungesa e fondeve	4.5	2	3	Ngritja e kapaciteteve për mbledhjen e fondeve; avancimi i raporteve me komunitetin akademik e me donatorë;

				avancimi i profilit specifik të ORCA-s; forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar.
Qarkullimi i personelit	4	1	2	Motivimi i personelit; investimi në zhvillimin e personelit.

4.3 Strategjia e komunikimit

ORCA ka zhvilluar një proces me pjesëmarrje relativisht përfshirëse për hartimin e Planit Zhvillimor 2020-2024. Plani është miratuar fillimisht nga drejtori ekzekutiv e pastaj nga kuvendi i ORCA-s. Pas miratimit të Planit, ORCA do ta publikojë pjesët përkatëse të Planit në uebfaqen e vet, në faqen në Facebook, si dhe në platforma përkatëse për informim dhe pranim të informatave kthyese nga komuniteti, nga organizatat joqeveritare dhe nga komuniteti akademik në Kosovë e më gjerë.

Aktivitetet e strategjisë së komunikimit për këtë plan do të bashkërenditen nga ZDE dhe nga zyrtari përgjegjës për informim. Kohë pas kohe, ORCA do të bashkëpunojë me partnerët e ndryshëm vendorë e ndërkombëtarë - sidomos në kohën e shqyrtimit të zbatimit dhe rishikimit të planit. ORCA do të organizojë mbledhjen e rregullt të informatave dhe raportimin vjetor lidhur cilësinë e zbatimit të Planit, si dhe do të informojë palët e interesit lidhur me këtë.

Pas miratimit nga Kuvendi, ORCA-s do të hartojë materialet për informim të palëve të interesit në fushën e arsimit, përfshirë komunitetin akademik, donatorët, autoritetet, OJQ-të dhe bizneset. Për këtë qëllim do të hartohen fletëpalosje dhe broshura përkatëse informuese, ndërsa në uebfaqe do të jetë vazhdimisht i publikuar plani. Materialet në uebfaqe do të publikohen në gjuhën shqipe, angleze dhe në gjuhët lokale në mënyrë që të mbërrijë sa më shumë përfitues dhe palë të interesuara.

Pos kësaj do të organizohen edhe takime informimi me donatorë, partnerë e biznese për të mobilizuar entitetet e caktuara për zbatimin e masave të planifikuara në plan, e sidomos për përkrahjen e aktiviteteve që kanë të bëjnë me aktivizmin studentor (përfshirë Qendrën e Aktivizmit Studentor). Pastaj, do të organizohet një ngjarje informative me autoritetet, donatorët dhe mediet me qëllim të informimit të ndërsjellë dhe për vlerësimin e mundësive për mbulimin e aspekteve të Planit varësisht nga interesimi dhe mundësitë e palëve të përfshira.

Secilin vit, në muajin korrik do të bëhet shqyrtimi i zbatimit të masave të planit dhe hartimi i planit vjetor të veprimit. Në këtë punëtori të rishikimit e të planifikimit do të përfshihen edhe partnerët e ORCA-s në sektorin e arsimit të lartë dhe mediet. Këto punëtori shqyrtuese do të shërbejnë edhe për të rishikuar e shtuar mobilizimin e partnerëve për zbatimin sa më të mirë të tij. Në veçanti, gjatë procesit të shqyrtimit të zbatimit, do t'i kushtohet rëndësi masave që kanë të bëjnë me organizatat studentore, aktivizmin studentor, integritetin akademik, drejtësinë shoqërore e të tjera.

Në vitin 2022 do të bëhet rishikimi i ndërmjetëm i zbatimit të planit. Me këtë rast do të organizohet një punëtori me përfshirje më të gjerë, duke përfshirë donatorët, partnerët, komunitetin akademik, OJQ-të, autoritetet arsimore qendrore dhe partnerët rajonalë. Ky proces do të nënkuptojë një shqyrtim të zbatimit dhe rishikim të masave të parapara në planin origjinal. Kjo do të bëhet për t'i përshtatur masat me kontekstin e ndryshuar të sektorit të arsimit – me fokus në arsimin e lartë - në Kosovë e më gjerë. Kjo ngjarje do të shërbejë edhe për mobilizimin e mjeteve shtesë për financimin e planit, por edhe për kapitalizimin nga mundësi të tjera për zbatim të Planit që mund të dalin si rezultat i avancimit të procesit të integrimeve evropiane dhe rritjes së interesimit të donatorëve, ose rritjes së interesimit të autoriteteve për bashkëpunim me OJQ në sektorin e arsimit.

Pos këtyre formave të komunikimit e informimit, do të shfrytëzohen edhe mjetet e informimit (elektronike dhe të shtypura) me qëllim të informimit sa më të mirë të opinionit për procesin zbatimit, përfshirë sfidat dhe sukseset, e këtij plani.

Shtojca 1: Analiza SWOT

• Metodat e reagimit e të presionit • Krijimi i perceptimit pozitiv në publik • Qasja e mirë në komunikim me publikun dhe partnerët • Aftësitë hulumtuese dhe avokuese • Guximi në adresimin e çështjeve • Staf i ri dhe energjik • Përkushtimi ndaj çështjeve • Fryma aktiviste • Kombinimi pragmatik i qasjes kritike e bashkëpunuese • Profesionalizmi dhe korrektësia në hulumtime dhe publikime • Kredibiliteti • Qasja jokonvencionale dhe radikale dhe adresimin e çështjeve • Produktiviteti dhe Vitaliteti i organizatës • Qasja innovative • Qasja bashkëpunuese me institucionet	• Infrastrukturë e pamjaftueshme për realizimin e qëllimeve programore • Qarkullimi i lartë i personelit • Mungesa e rregulloreve dhe procedurave Paqëndrueshmëria financiare • Buxheti i kufizuar për realizimin e qëllimeve programore • Mungesa e personelit të dedikuar për komunikim • Personeli i mbingarkuar • Mungesa e një strategjie të komunikimit • Mungesa e kapaciteteve për disa qëllime programore • Menaxhimi • Shpërputhja në mes të misionit rinor dhe moshës së personelit (mission and aging) • Mungesa e personelit mbështetës dhe teknik
• Ekspertiza dhe fusha e veprimit të ORCA-s është e kërkuar në sektorin e arsimit të lartë • Imazhi pozitiv i krijuar te mediet • Proceset integruese evropiane • Përkrahja nga organizatat ndërkombëtare • Disponimi i publikut kundër korrupcionit • Nevoja për organizim të mirëfilltë studentor • Ndjeshmëria e shtuar e qytetarëve ndaj problemeve të arsimit të lartë • Interesimi i donatorëve për bashkëpunim me organizatat e profilizuara • Frika e institucioneve dhe personelit akademik prej turpërimit publik • Qasje më konstruktive e politikës ndaj nismave në AL • Gatishmëria e shtuar e institucioneve publike për bashkëpunim • Perceptimi i ORCA-s si organizatë me standarde të larta profesionale dhe integritet • Infrastrukturë ligjore që mundëson transparencë dhe monitorim të pjesëshëm • Imazh pozitiv i organizatës ndër studentët • Nevoja e organizatave studentore për forcimin e aktivizmit.	• Burokracia e donatorëve • Ndryshimet e shpeshta dhe paqëndrueshmëria qeveritare • Mos-zbatimi i dispozitave ligjore • Rënia e interesimit dhe financimit nga ana e donatorëve • Apatia dhe pasiviteti i studentëve e mësimdhënësve • Fushatat anti-ORCA • Afërsia e tepruar me institucionit karshi aktivizmit studentor • Grupet e interesit të kolegjeve private • Ndërhyrjet politike • Mungesa e profesionalizmit të disa OJQ-ve aktive në fushën e arsimit • Rënia e interesimit të donatorëve për AL • Jostabiliteti politik • Mungesa e bashkëpunimit të OJQ-ve në fushën e arsimit • Mungesa e të dhënave e informatave të besueshme • Mungesa e analizave të mirëfillta sektoriale • Rezistenca ndaj ndryshimeve në institucione arsimore • Mungesa e ekspertizës në fushën e integritetit akademik në AL • Mungesa e qasjes ndërsektoriale

Shtojca 2: Plani i veprimi

Objektiva / masa	Aktiviteti	Përgj egjës	Inputet	Kostoja	Koha e zbatimi					Gjithsejt
3.1 Menaxhimi dhe procedurat					2020	2021	2022	2023	2024	
3.1.1 Hapësira	Kontraktimi dhe furnizimi me pajisje		150 m2 objekt Qiraja mujore 1250 Eur Sherbime komunale 100/muaj Material per zyre 50/muaj	15000 €/vit 1200 600	15000 1200 600	15000 1200 600	15000 1200 600	15000 1200 600	15000 1200 600	84000
3.1.2. Rregulloret	Kontraktimi i hartuesve e punëtoria		Punëtoria 500	500 €	500	500	500	500	500	2500
3.1.3. Organogrami	1. Drejtori Ekzekutiv 2. Zv. Drejtori Ekzekutiv 3. Menaxheri i Hulumtimit 4. Menaxheri i Aktiviteteve 5. Menaxheri i Administratës dhe Financave 6. Menaxheri i Projekteve		1. € 1,600.00 2. € 1,500.00 3. € 1,200.00 4. € 1,200.00 5. € 1,200.00 6. € 1,000.00 7. € 1,000.00 Pagat maksimale	10440 0 / vit	10440	10440	10440	10440	10440	522000
3.1.4. Ekspertiza e specializuar	Kontraktimi		8 ditë pune X 250 € Vlerësim	2000€	2000 €	2000 €	2000€	2000 €	2000 €	10000
3.1.5. Përmirësimi i planifikimit	Blerja e softverit Aftësimi (Gant Chart)		300 € softveri Aftësim njëditor 300 €	600 €	600		600		600	1800
3.1.6. Stafi teknik / asistenca	Rekrutimi									

3.1.7. Presioni publik	Monitorimi / hulumt. Takime, platforma, rrjete, presion		5 aktivittete të presionit publik në vit x 250	1250	1250	1250	1250	1250	1250	25000
3.1.8. Bordi i ORCA-s	Rishikimi i rolit dhe takime të përbashkëta		Takime të përbashkëta Drekë pune një herë në vit	200 €	200	200	200	200	200	1000
3.1.9. Qendra e Aktivizmit Studentor	Hapësira, takime, punëtori, shërbime		Takime në vit: 1000 € ushqim dhe pije Trajnime në vit: 2000 (8 d/p x 250) Evente në vit: 2 x 1000 € Mbështetja e aktiviteteve të grupeve studentore në vit: 5000"	10000	10000	10000	10000	10000	10000	50000
3.1.10. Ngritje kapacitetesh të OJQ në Arsim të Lartë dhe Shkencë	Hartimi i pakos e organizimi i punëtorive		Pakoja: 1500 € Punëtoritë: X 1000 € "	2500	2500	1000	1000	1000	1000	6500
3.1.11. Standartet e Hulumtimit	Hartimi, prezantimi, pilotimi.		Hartimi: 5 d/p = 1000 € Prezantimi: 200 € pije	1200	1200		1200			2400
3.1.12. Monitorimi i zbatimit të parimeve të etikës akademike në AL	Hartimi i procedurave, zbatimi i monitorimit, hartimi e publikimi i raporteve, prezantimi, tryezat.		Mbulohet nga personeli ORCA	0	0	0	0	0	0	0
										705200
3.2. Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare				Kosto	2020	2021	2022	2023	2024	Gjithsejt
3.2.1. Aplikimi për grante	Hulumt. i donatorëve, hartimi i projekteve, aplikimi		Personeli Personeli + ekspertizë 20 d/p	5000	5000	5000	5000	5000	5000	25000

3.2.2. Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare	Studimi i problemeve Komunik. me donatorë Hartimi i projekteve		Analizat vjetore: 20 d/p Projektet: 20 d/p	5000 5000	1000 0	5000	5000	1000 0	5000	35000
3.2.3. Vizibiliteti	Udhëzuesi Zbatimi i udhëzuesit		Hartimi: 10 d/p Personeli	2500	2500	/	/	/	2500	5000
3.2.4. Fondi i Aktivizmit Studentor	Konkurrimi për sponsorizim; Aktivitete të tjera		Projekte: 20 d/p Aktivitete: personeli	5000	5000	5000	5000	5000	5000	25000
										90000
3.3. Ngritja e kapaciteteve				Kosto	2020	2021	2022	2023	2024	Gjithsejt
3.3.1. NK për mbledhje të fondeve	Hartimi i udhëzuesit, punëtoria,		Hartimi: 10 d/p Punëtoria: 1000 €	3500	3500	2500	2500	2500	2500	13500
3.3.2. Formimi Ekipor	Diskutime Punëtori Përkrahja e personelit		"Punëtori planifikuese: 2000 në vit Zhvillim i aftësive të personelit: 2 trajnime ne vit x 1000"	4000	4000	4000	4000	4000	4000	20000
3.3.3. Rekrutimi i personelit profesional	Vlerësimi i nevojave Shpallja e konkursit Rekrutimi		Personeli Personeli Personeli	/	/	/	/	/	/	/
3.3.4. Angazhimi i vullnetarëve	Konkursi Angazhimi Certifikimi		Personeli Personeli Personeli	/	/	/	/	/	/	/
3.3.5. NK hulumtim, monitorim dhe lobizim	Tri punëtori tematike në vit Vlerësimi i punës		Një punëtori në vit x 1000 Monitorimi: personeli	1000	1000	1000	1000	1000	1000	5000
3.3.6. Aftesimi për PRAG e rregulloret e ngjashme	Hartimi dhe zbatimi i programit Forma të tjera		Aftësim: 1000 € Personeli i financave: vlerësim – 2000 €	3000	3000	/	/	3000	/	6000
3.3.7. NK menaxhimi i projekteve	Zbatimi i programit të aftësimit		1 punëtori në vit: 1500 €	1500	1500	/	1500	/	1500	4500
3.3.8. NK analizë e përpunim të dhënave	Blerja e softvereve Aftësimi i personelit		Softverët: 500 € Aftësimi – 1 punëtori: 1000 €	1500	1500	/	/	/	/	1500

3.3.9. NK komunikim dhe marrëdhënie me publikun	Hartimi i programit Zbatimi i programit Vizitat studimore Vlerësimi i efektit		Hartimi: 500 € Zbatimi: personeli Vizitat: 1000 € Personeli	1500	1500	1000	1000	1000	1000	5500
										56000
4 3.4 Komunikimi dhe bashkëpunimi				Kost	2020	2021	2022	2023	2024	Gjithsejt
3.4.1. Strategjia e komunikimit	Rishikimi, Hartimi Publikimi, rishikimi		Rishikimi: personeli Hartimi: 2500 € Publikimi: 300 €	2800	2800	/	/	/	1500	4300
3.4.2. Hulumtimi i trendeve në aktivizmin studentor	Organizohen hulumt. Hartohet prog. AS Takime të rregullta		Hulumtimi: 10 d/p Hartimi: 10 d/p Takime: 10 X 100 € Aktivitete: 10 X 100 €	2500 2500 1000 1000	7000	4500	4500	7000	4500	27500
3.4.3. Ngritja e vetëdijes së opinionit publik	Ngjarje të ndryshme									
3.4.4. Ndërhyrjet politike dhe reagimi ndaj tyre	Paralajmërimi Aktivitete reagimi Takime në KP ASHKRS Publikimi i ndërhyrjeve		Paralajm: Personeli Aktivitete: Personeli Takimi: Personeli Publikimi: 300 €	300	300	300	300	300	300	1500
3.4.5. Kauzat e përbashkëta të OJQ	Identifikimi i kauzave Aktivitetet/ promovim		Identifikimi: Personeli Aktivitete: 5 X 100 €	500	500	500	500	500	500	2500
3.4.6. Bashkëpunimi rajonal e ndërkombëtar	Komunikimi Raporti (Analiza e sit.) Projekte të përbashk.		Komunik: personeli Raporti: 20 d/p Projekte: vlerësim 20 d/p	5000 5000	10000	5000	5000	5000	10000	25000
3.4.7. Përkrahja e Organizatave studentore	Grante të vogla AS Grante përkrahje e OS Monit. i zbatimit		Grante: 20 X 500 € Grante: 10 X 1500 € Monitorim: personeli	10000 15000	25000	25000	25000	25000	25000	100000
3.4.8. Partneriteti me mediet	Takimet me mediet Materialet tematike		5 takime X 200 € Personeli	1000	1000	1000	1000	1000	1000	5000
3.4.9. Platforma mediale për arsim	Video transmetime Animacione Gazeta		Pajisje 1500 Softver 600	10100	10100	3600	3600	3600	3600	24500

	Uebfaqja		gazeta Tempulli I Dijes 2 ne vit x 1500 = 3000 uebfaqja e Tempullit te Dijes 5000							
										190300
Grand total										1041500